



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Teknik laborator në Mjekësi”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar REALD”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Vjollca Durro

2. Nevila Alliu

Janar 2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bsc në “Teknik laborator në Mjekësi” ofruar nga IAL
Kolegji Universitar “REALD”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Teknik laborator në Mjekësi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 422, date 16.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE/1 PAK v.a 2018-2019 13 PAE/2 PAK v.a 2019-2020 15 PAE/4 PAK v.a 2020-2021
18	Numri i studentëve:	6 studentë v.a 2018-2019 15 studentë v.a 2019-2020 21 studentë v.a 2020-2021
19	Komente / të tjera:	-


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Shkurtime

- KUR Kolegji Universitar "REALD"
- FSHM Fakulteti i Shkencave Mjekësore
- DSHTM Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
- MPMI Master Profesional Menaxhim Infermieror
- BADM Bordi i Administrimit KUR
- SA Senati Akademik
- ASCAL Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
- GVB Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
- BA Bordi i Akreditimit
- VBA Vendim i Bordit të Akreditimit
- VKM Vendim i Këshillit të Ministrave
- ZBNJ Zyra e Burimeve Njerëzore
- RVB Raport i vlerësimit të brendshëm
- RSH Republika e Shqipërisë
- NJSBC Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- MASR Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
- KSH Kërkim Shkencor



TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "REALD"(KUR) është një institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011, si Akademia e Studimeve të Aplikuara "REALD". Në vitin 2017 është riorganizuar duke marrë emrin Kolegji Universitar "REALD".

Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 93, datë 20.10.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike e vlefshme deri më deri në 19/10/2022.

KUR përbëhet nga 2 njësi kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Secili fakultetet përbëhet nga 3 njësi bazë, si vijon:

Fakulteti i Ekonomisë: Departamenti i Financës, Departamenti i Menaxhimit dhe një Qendër Kërkimore;

Fakulteti i Shkencave Mjekësore: Departamenti i Farmacisë, Departamenti i Stomatologjisë dhe Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore.

KUR, për vitin akademik 2020-2021, ka pasur aktive 12 programe studimi në total, nga të cilat 2 programe 2 vjeçare, 5 programe Bachelor, 2 programe të integruara studimi, 1 program Master i Shkencave dhe 2 programe Master Profesional. Numri total i studentëve për vitin akademik 2018-2019 ka qenë 260 studentë.

Programi i studimit bachelor ne "Teknik laborator ne Mjekesi" është hapur me Urdhër të MASR Nr. 422, datë 16.07.2018, me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit periodik të programit të studimit bachelor në “Teknik laborator ne Mjekesi” (TLM), i ofruar nga Kolegji Universitar “REALD”, (KUR). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të parë për programin Bsc në “Teknik laborator ne Mjekesi”, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit [ascal.al] të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimëve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave].

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof.As. Vjollca Durro dhe Dr. Nevila Alliu. Koordinatorë Teknikë e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Muhamed Prezja.



Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në KUR e zhvilluar në datat 04 dhe 05 tetor 2021. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e KUR. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion. GVJ mirëkupton vështirësitë e hasura nga ana e institucionit në këtë periudhë të vështirë të shkaktuar nga pandemia Covid 19 në koordinimin e brendshëm gjatë periudhës së kufizimeve dhe zhvillimi të veprimtarive akademike online.


Gjithashtu, GVJ falenderon ASCAL dhe Koordinatorin Teknik për mënyrën e menaxhimit dhe korrektësinë e treguar gjatë gjithë procesit.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Teknike laboratorit në mjekësi”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien Programet e studimit të ofruara nga KUR bazohen në studime të tregut të kryera nga institucioni lidhur me nevojat që ka rajoni dhe vendindesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” (KUR) është një institucion jopublik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 93, datë 20.10.2017 për një afat 5 vjeçar, deri më deri në 19/10/2022. Programet që ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit. Hapja e programit të studimit “Teknik laboratorit në Mjekësi” është në përputhje me zhvillimin ekonomik të rajonit jugor dhe bazohet në studime të nevojave e tregut të punës kryera nga institucioni. [dokumenti studimi i tregut në fushën e shëndetësisë, programi mësimor, takimi me drejtuesit].</p> <p>Bazuar në statutin dhe rregulloren e IAL programet e ofruara nga KUR synojnë përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme dhe janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e kolegjit. KUR ka fokusuar veprimtarinë e tij në dy drejtime kryesore, atë të shkencave ekonomike dhe mjekësore dhe në këtë kuadër edhe programet janë në këto drejtime studimi. [statuti KUR, rregullore e përgjithshme KUR, www.ascal.al, numri i programeve]</p> <p>Referuar dokumentacionit mbështetës të RVB, GVJ konstaton se programi Bsc “Teknik laboratorit në Mjekësi”(TLM) është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të KUR dhe Strategjisë së zhvillimit institucional 2021-2026.</p> <p>Programi bachelor “Teknik laboratorit në Mjekësi”ka një ndërthurje të dijeve teorike me ato praktike të cilat i mundësojnë studenteve aftësimin e tyre profesional për të qënë konkurent në tregun e punës. Zhvillimi dhe realizimi i programeve të studimit janë në të njëjtën linjë me zhvillimet social-ekonomike të vendit, shëndetësisë apo politikave rajonale të Qarkut të Vlorës. [dok nr 13. Plani i në teknik laboratorit, strategjia e zhvillimit 2021-2026]</p>			
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>				
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>				
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Program Bsc në "Teknike laboratorit në mjekësi" është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin e KUR dhe rregulloren e institucionit, Ligjin 80/2015 për "Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Institucioni ka hartuar një strategji zhvillimi institucionale të KUR për vitet 2021-2026. GVJ vëren se në këtë strategji, institucioni ka të përcaktuara qartë drejtimit strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat janë në përputhje me fushën e veprimtarisë së KUR.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Bazuar në dokumentacione të vëna në dispozicion GVJ konstaton se statusi KUR, strategjia e zhvillimit institucionale dhe rregullorja e FSHM përcaktojnë qartë objektivat dhe drejtimit kryesorë të zhvillimit akademik të institucionit. Statuti i KUR është miratuar me Urdhër Nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit dhe Rregullorja e përgjithshme është miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, Rregullorja e Fakultetit të shkencave mjekësore të miratuar me vendim të senatit akademik Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017. KUR ka hartuar dhe miratuar edhe rregulloret e njësisve dhe strukturave të tjera. Programet e studimit të ofruara nga institucioni janë në përputhje me fushën e veprimtarisë së IAL dhe dy drejtimit kryesorë që ai ofron, shkencë ekonomike dhe mjekësore. [lista e programeve FSHM, rregullore e përgjithshme e KUR, rregullore NJSBC, rregullore e sekretarisë, rregullore e zyrës së burimeve njerëzore, rregullore e programit të studimitetj].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e	Programi i studimit paraqet në mënyrë përmbledhëse misionin dhe objektivat e tij [rregullorja e programit Bsc. "Teknike laboratorit në mjekësi]. Bazuar në këto objektiva, programi synon formimin teorik dhe përgatitjen praktike profesionale, në mënyrë që të mundësojë përvetësimin e njohurive të rëndësishme lidhur me Teknikë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

programit.	Laboratori në Mjekësi.			
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, takimin me drejtuesit e FSHM dhe departamentit GVJ konston se institucioni mban kontakte të vazhdueshme me institucionet shëndetësore publike të qytetit të Vlorës dhe rajonit të jugut, Urdhërin e Infermierit të qarkut Vlorë, lidhur me nevojat e tregut të punës për teknike laborator duke mbledhur të dhëna për vëndet e lira të punës, numrin e presonelit që del në pension, numrin e studentëve të FSHM të punësuar pas diplomimit. Për studimin e tregut të punës institucion shfrytëzon dhe të dhënat nga portal i punësimit, website të agjensive të punësimit, të institucioneve shëndetësore publike kombëtare. [Takimi me stafin drejtues, dokumenti 12. Studimi i tregut të punës në mjekësisë].</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” e për këtë arsye objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, që matin rezultatet e pritshme të të nxënit, që garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut e që mundësojnë punësimin e shpejtë të studentëve, janë pasqyruar qartë.</p> <p><i>Një element i rëndësishëm në formimin profesional të studentëve janë laboratorët mjekësorë. Institucioni nuk ka laboratore mjekësore për realizimin e praktikave mesimore në këtë program studimi të cilat ju shërbejnë studentëve për fitimin e shprehive të punës duke ju krijuar një ambient të ngjashëm me ambientet e laboratorëve mjekësore në struktura shëndetësore [programi i studimit, vizita në ambientet e FSHM]. Gjatë vizitës me stafin drejtues dhe atë të programit theksuan se ngritja e laboratorit mjekësor është në proces.</i></p> <p>Një nga komponentët më të rëndësishëm të programit është praktika profesionale e cila zhvillohet në vitin e dytë dhe të tretë. Në programet e studentëve në viti e II dhe të III vihet re një ndarje të oreve teorike dhe praktikë si dhe ndarja e studentëve në grupe sipas numrit të rekomanduar për realizimin e praktikës profesionale.</p> <p>Pasja e një numri të vogël studentësh, jep mundësi për praktikimin e njohurive në qendrat shëndetësore rajonale, laboratore mjekësore publik dhe jo publik dhe fitimin e aftësive profesionale , kompetencave për tu përballur me kërkesat e tregut te punes.</p> <p><i>GVJ rekomandon ngritjen e laboratoreve mjekësore për realizimin e praktikës lëndore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

Standardi I.4**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>KUR është licensuar fillimisht si Akademia e Shkencave të Aplikuara “Reald”. Në vitin 2017 është riorganizuar duke marrë emrin Kolegji Universitar “REALD”.</p> <p>Institucioni ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë (licensuar me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011 dhe akredituar me VBA Nr. 93, datë 20.10.2017 me kohëzgjatje 5 vite akademike), çka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe që ndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit [takimi me stafin drejtues, stafin akademik dhe mbështetës, vizita në ambientet e KUR; dok 34. Te dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit].</p> <p><i>GVJ e konsideron pikë të dobët mungesën e laboratorëve mjekësorë për realizimin e praktikës lëndore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ evidentoi se institucioni ka kapaciteteve akademike të mjaftueshme për realizimin e programeve të studimit ku shumica e lëndëve/moduleve mbuloheh kryesisht nga stafi akademik efektiv por konstatojmë mos përputhje të formimit të tyre profesional me lëndën e programit që realizojnë.</p> <p>FSHM ka 31 staf akademik efektiv në fushën e mjekësisë që zotërojnë tituj dhe grada shkencore, por pjesa më e madhe e pedagogëve janë Msc.</p> <p>Për realizimin praktikës profesionale të studentëve FSHM kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike të qarkut të Vlorës si spitali rajonal Vlorës, Spitali psiqiatrik Vlorë, spitali Fierit, Laboratorin Novida, Laboratorin biokimik Dielli, Laboratorin mjekësor Magic Ballkans [dok. 19 lista e mrëveshjeve, dokumentet nr nga 20-28 Marveshjet me secilin institucion].</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore(FSHM) përbëhet nga tre departamente Departamenti farmacisë, Departamenti i stomatologjisë, departamenti i shkencave mjekësore teknike. FSHM në total ofron 8 programe të ciklit të parë dhe të dytë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bachelor në “Infermieri”; - Bachelor në “Fizioterapi”; - Bachelor në “Teknik Laboratori në Mjekësi”; - Program i integruar “Master i shkencave” në “Stomatologji”; - Program i integruar “Master i shkencave” në “Farmaci”; - “Master profesional” në “Menaxhim Infermior”; - “Master profesional” në “Fizioterapi”; - Program profesional (2 vjeçar) në “Ndihmës dentar.



	<p>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore [dokumenti nr 5. Regullorja e FSHM].</p> <p>Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit.</p> <p>Niveli i njohurive që ofron programi përkon me atë të nivelit të 6 KSHK / EQF [dosja e programit].</p> <p>Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore ku zhvillohet ky program studimi ka 14(katërbëdhjetë) staf akademik efektiv, 4(katër) staf akademik me kontratë që kanë tituj dhe grada shkencore. Departamenti nuk ka staf akademik mbështetës/ laborant në funksion të programeve të studimit që ofron.</p> <p>[dokumnti 3. Palni mësimor në programin e studimit Bsc në teknik laboratorori në mjekësi]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore teknike është pjesë e KUR. FSHM ofron 8 programe studimi ku përfshihet dhe programi i studimit Bsc Teknik Laboratori në Mjekësi. Në këtë program studimi në të tre vitet akademike janë reth 50 studentë. [dok. Nr 84 Të dhena mbi regjistrimin e studenteve ne programin bachelor TLM]. Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit [takimi me drejtuesit], bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. Bashkëpunimi dhe detyrat brenda njësisë bazë apo programeve bazohen në rregulloren e funksionimit të FSHM dhe rregullores së programit të studimit dhe analizohen çdo vit akademik në raportin vjetor të analizës së veprimtarisë së FSHMT [dokumnti nr 59 raporti vjetor IAL].
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Për realizimin e procedurave të ndryshme vlerësues, rekrutim stafi akademik etj funksionojnë ngritja e grupeve “ad hoc” në përbërje të të cilit janë anëtarë të stafit akademik. Në fillim të çdo viti akademik, dekanati koordinon orarin mësimor dhe

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.

Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

ngarkesës mësimore të stafit akademik midis njësive bazë të FSHM apo departamenteve të lëndëve jo mjekësore si dhe të institucioneve shëndetësore ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi. **[takimi me drejtuesit, rregullorja e FSHP, raporti analizës vjetore të departamentit]**

Për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Teknik Laboratori në Mjekësi”, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore dhe shëndetësore brënda dhe jashtë vëndit. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me spitalet e Vlorës, Fierit, Spitali Psikiatrik Vlorë, poliklinikën qendrore Vlorë, Laboratorin Novida, Laboratorin biokimik Dielli, Laboratorin mjekësor Magic Ballkans Universiteti Mjekësor i Tiranës, Universiteti European i Tiranës, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Universiteti i Fogias /Itali, Universiteti i Mesinës / Itali, Universiteti i Salernos / Itali, Universiteti Murcias (UCAM)/ Itali, Kolegji “Pjetër Budi” Prishtinë / Kosovë, Kolegji “Heimerer” (Arsim dhe Karrierë në Shëndetësi) / Kosovë, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës/ Maqedoni e Veriut. Këto marrëveshje bashkëpunimi ndihmojnë studentët të zhvillojnë praktikën profesionale, realizimin e temave të diplomës apo kërkimit shkencor si dhe krijimin e kontakteve për punësimin në vazhdimësi pasi disa prej bashkëpunëtorëve janë punëdhënës të drejtpërdrejtë.


Departamenti i shkencave mjekësore teknike, si njësi bazë ku realizohet ky program studimi, në mënyrë periodike analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bsc. Teknik laboratorit në Mjekësi si ecuria e zhvillimit të praktikës profesionale, realizimin e aktiviteteve të përbashka me institucionet arsimore dhe shëndetësore, realizimin e temave projekteve të ndryshme **[dok 30. raporti analitik për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit në programin Bsc TLM).**

Për realizimin e këtij program studimi FSHM dhe departamenti SHMT, në fillim të vitit akademik për mbikëqyrjen dhe koordinimin e realizimit të praktikës profesionale, temave të diplomës emëron koordinatorin apo pedagogët e praktikës nga programi i studimit dhe institucionit ku realizohet praktika bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me këto institucione. Për mbikëqyrjen e praktikës 1 pedagog ndjek 10-15 student. Praktika realizohet sipas sylabusit përkatës të praktikës profesionale **[dok, nr 3 dokumnetacioni shtesë. Programi mësimor Bsc TLM; sylabuset, dok i marrëveshjeve e bashkëpunimit me institucionet shëndetësore, dok nr.30. raporti analitik për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit në programin Bsc TLM]**

Bazuar në rregulloren e institucionit, edukimi në vazhdim dhe shërbimet komunitare është një nga misionet e FSHM. FSHM organizon workshope, seminare, leksione të hapura, trajnime në bashkëpunim me mjekë të Spitalit të Fierit, Vlorës, Konferenca të kombëtare dhe ndërkombëtare sipa një plani paraprak të miratuar nga IAL, por për shkak të situatës të shkaktuar nga pandemia e covid 19,


	këto aktivitetet kanë të pakta.[dokumenta shtese, dok nr 2. Projekte - aktivitete shkencore].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi Bsc Teknik Laboratori në Mjekësi është hapur për herë të parë me Urdhër Nr. 422 datë 16.07.2018 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore i FSHM sipas nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe organizohet në 180 ECTS, kohëzgjatje 3 vite akademike, të ndarë në dy semestra për çdo vit akademik, në total 6 semestra, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 të MASR datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Në total programi ka 4688 orë prej të cilave 52.3% janë jashtë auditorit.</p> <p>Studimet përmbillen me provim përfundimtar formimi dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Bachelor në Teknik Laboratori në Mjekësi” [Rregullorja FSHM dhe rregullorja e programit të studimit, kurikula e programit]. Departamenti nuk ofron mbrojtje diplomash për mbylljen e studimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni. Programi i studimit synon rritjen e kapaciteve profesionale në zbatimin e teknikave në fushën e mjekësisë laboratorike duke u përpjekur të sigurojë informacionin bazë për përgatitjen e teknikëve të laboratorit mjekësor dhe aftësimin e tyre në kuptimin dhe aplikimin e metodave të thjeshta e komplekse laboratorike. Qëllimi i programit është dhënia e njohurive dhe fitimi i kompetencave për kryerjen teknike të analizave të ndryshme mjekësore si mikrobiologjike, biokimike, histopatologjike, hematologjike etj. [Programi studimit Bsc në Teknik Laboratori Mjekësor, plani mësimor. Evd. 9]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Teknik Laboratori në mjekësi përmban informacion në fushën e mjekësisë laboratorike dhe teknikave të vlerësimit të parametrave laboratorike. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme, në fushat specifike dhe të specializuara të mjekësisë laboratorike si dhe i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës si brenda edhe jashtë vendit dhe përfitimin e njohurive të tyre profesionale bazë për kualifikime të mëtejshme.</p> <p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi gjatë orëve në auditor apo kryerjes së praktikave profesionale, tentojnë t’ju shërbejnë studentëve për përfitimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për aplikimin e teknikave bazë dhe të avancuara laboratorike. Bazuar në vlerësimin e programit të studimit, bazës laboratorike të munguar dhe gjithashtu nga intervistat me studentët, GVJ vlerëson se pas përfundimit të këtij</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Teknik Laboratori në mjekësi përmban informacion në fushën e mjekësisë laboratorike dhe teknikave të vlerësimit të parametrave laboratorike. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme, në fushat specifike dhe të specializuara të mjekësisë laboratorike si dhe i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës si brenda edhe jashtë vendit dhe përfitimin e njohurive të tyre profesionale bazë për kualifikime të mëtejshme.</p> <p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi gjatë orëve në auditor apo kryerjes së praktikave profesionale, tentojnë t’ju shërbejnë studentëve për përfitimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për aplikimin e teknikave bazë dhe të avancuara laboratorike. Bazuar në vlerësimin e programit të studimit, bazës laboratorike të munguar dhe gjithashtu nga intervistat me studentët, GVJ vlerëson se pas përfundimit të këtij</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Teknik Laboratori në mjekësi përmban informacion në fushën e mjekësisë laboratorike dhe teknikave të vlerësimit të parametrave laboratorike. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme, në fushat specifike dhe të specializuara të mjekësisë laboratorike si dhe i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës si brenda edhe jashtë vendit dhe përfitimin e njohurive të tyre profesionale bazë për kualifikime të mëtejshme.</p> <p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi gjatë orëve në auditor apo kryerjes së praktikave profesionale, tentojnë t’ju shërbejnë studentëve për përfitimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për aplikimin e teknikave bazë dhe të avancuara laboratorike. Bazuar në vlerësimin e programit të studimit, bazës laboratorike të munguar dhe gjithashtu nga intervistat me studentët, GVJ vlerëson se pas përfundimit të këtij</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Teknik Laboratori në mjekësi përmban informacion në fushën e mjekësisë laboratorike dhe teknikave të vlerësimit të parametrave laboratorike. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme, në fushat specifike dhe të specializuara të mjekësisë laboratorike si dhe i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës si brenda edhe jashtë vendit dhe përfitimin e njohurive të tyre profesionale bazë për kualifikime të mëtejshme.</p> <p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi gjatë orëve në auditor apo kryerjes së praktikave profesionale, tentojnë t’ju shërbejnë studentëve për përfitimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për aplikimin e teknikave bazë dhe të avancuara laboratorike. Bazuar në vlerësimin e programit të studimit, bazës laboratorike të munguar dhe gjithashtu nga intervistat me studentët, GVJ vlerëson se pas përfundimit të këtij</p>



programi, studentët kanë disa mangësi në njohuritë dhe kapacitete nevojshme profesionale për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike si dhe zgjidhjen e problematikave në praktikën e përditshme në fushën e mjekësisë laboratorike. [Vizita në ambiente, programi i studimit, takimi me studentët]

Programi i studimit Bsc në Teknik në Laboratori në Mjekësi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sipas akteve ligjore në fuqi. Programi Bsc TLM është i organizuar me kohë të plotë në 3 vite akademike të ndarë në 6 semestra, me 60 ETC për çdo vit akademik në total 180 ETCS, (2234orë mësimore në auditor dhe 2454 jashtë auditorit) nga të cilat praktikës profesionale i shkojnë 24 kredite dhe provimit përfundimtar i shkojnë 10 kredite. Në RVB deklarohet se mbyllja e programit mund të bëhet dhe me mikroteze, por një fakt i tillë nuk evidentohet në rregulloren e programit dhe gjithashtu asnjë nga studentet në prag diplomimit nuk kishte marrë tëmë për mikrotëzë. Ngarkesa mësimore javore është 20-25 orë. **[Evd. 8. Rregullore e programit].**

Lëndët e programit realizohen sipas orarit mësimor të miratuar dekanati. **[evd. 39.40. Orari Teknik Laboratori në Mjekësi.]**

Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të dy semestrat janë organizuar në leksione, seminare, projekte/detyra kursi, praktikë mësimore/profesionale.


Në të tre vitet akademike , studentët ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve shëndetësore me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi **[marrëveshjet e bashkëpunimit]**. Praktika profesionale është 24 ECTS /525 orë. Ajo mbikëqyret nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika dhe vlerësohet nga pedagogu mbikëqyres (takimi me stafin dhe drejtuesit). ***GVJ evidenton se programi nuk ka një rregullore/udhezues të shkruar mbi organizmin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën [Rregullorja e programit Bsc IP]***.

Programi i studimit Bsc në Teknik Laboratori në Mjekësi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.

Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në :

- Lëndë bazë me 26 ETC(14%)
- Lëndë karakterizuese 96 ETC(53%)
- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 21 ETC(11%)
- Lëndë plotësuese 27 ETC(15%)
- Detyrime përmblylëse 10 ETC(5%)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Akademia e Studimeve të Aplikuara “REALD” u licencua me Vendim Nr. 650, datë 14.09.2011, të Këshillit të Ministrave. Në vitin 2017 është riorganizuar duke marrë emrin Kolegji Universitar “REALD”.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Kolegji Universitar Reald ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në vitin 2013 dhe me tej ka marrë akreditimin periodik institucional me vendimin Nr. 93, datë 20.10. 2017 të bordit të akreditimit me një afat 5-vjeçar.</p> <p>Organet drejtuese të institucionit janë: a) Senati Akademik, b) Rektorati, c) Dekanati; d) Asambleja e personelit akademik; e) Këshilli i Etikës; f) Komisioni i përhershëm për Menaxhimin Akademik g) Komisioni i përhershëm për Sigurimin e Cilësisë h) Këshilli i Fakultetit i) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; j) Bordi i Administrimit Në Kolegji, autoritet drejtuese akademike janë: a) Rektori b) Dekani c) Përgjegjësi i Departamentit d) Zv/Rektori dhe Zv/Dekani Autoritete drejtuese administrative janë a) Administratori i Kolegjit b) Administratori i njësisë kryesore</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Ky program studimi realizohet pranë Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore dhe është hapur për herë të parë me Urdhër Nr. 422 datë 16.07.2018 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës . Gjatë kësaj periudhe programi nuk është riorganizuar dhe as ka pësuar ndryshime. Ky program i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore së bashku me Departamentin e Farmacisë dhe të Stomatologjisë. Departamenti ofron vetëm programi studimit BSC në Teknik Laboratori Mjekësor,</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Programi ka një koordinator të emëruar me dekret të Rektorit të Kolegjit i cili është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion. [evd 18. Urdhër për emërimin e Koordinatorit të programit]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Koordinatori i programit përgjigjet për organizimin dhe realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale, përgatitjen e syllabuseve sipas një formati të miratuar dhe raporton rregullisht tek dekani i FSHM [takimi me stafin, Takimi me drejtuesit ,takimi me studentët]. <i>GVJ evidenton se Detyrat dhe mënyra e raportimit të koordinatorit nuk janë të sanksionuara apo dokumentuara në asnjë nga rregulloret e institucionit apo të programit, në dokumentacionit e vënë në dispozicion. GVJ evidenton një dokument jo zyrtar që pëshkruan detyrat e koordinatorit. [Ev 490]</i></p> <p>Programi Bsc në Teknikë Laboratori në Mjekësi zhvillohet në Departamentit e Shkencave Teknike Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore. FSHM është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë”. Autoritet drejtuese janë dekani dhe drejtuesit e departamenteve, zv dekani. Në përberje të tij janë 3 njësi bazë: Tre departamente si njësi bazë mësimore, shtatë laboratorë si njësi ndihmëse dhe administrate (sekretaria mësimore, sekretar dhe personeli ndihmës për laboratorët mësimorë dhe klinikë).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

GVJ evidenton se asnjë nga nga laboratorët nuk i përket dhe nuk përmbush kërkesat e këtij program studimi. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore është përpjekur të angazhoi në programet e studimit staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo MS dhe staf ndihmës akademik/laborant.

Departamenti ku realizohet ky program studimi në tre vitet e fundit ka patur të angazhuar staf akademik si me poshte :

Për vitin akademik **2018-2019** ka : 15(pesëmbëdhjetë) pedagogë prej të cilëve 10(dhjetë) janë PAE dhe 5(pesë) pedagogë me kontratë (PAK).
Nga stafi PAE : 1 (një) Prof, 1(një) është Prof As., 1 (një) Dr.Sh. dhe 6(gjashtë)Msc. Nga stafi PAK 3 (tre) Dr.Sh. dhe 2(dy) Msc.

Për vitin **2019-2020** : 14(katërbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 9 (nëntë) janë Staf PAE dhe 5(tpesë) PAK.
Nga stafi PAE : 1 (një) Prof, 1(një) është Prof As., dhe 6(gjashtë)Msc. Nga stafi PAK 3 (tre) Dr.Sh. dhe 2(dy) Msc.

Për vitin **2020-2021** : 18(tetëmbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 11(mjëmbëdhjetë) janë PAE dhe 7(shtatë) PAK
Nga stafi PAE : 1 (një) Prof, 3(tre) DrSh. 6(gjashtë)Msc. dhe 1(një) MP . Nga stafi PAK: 1 (një) Prof Ass, 2 (dy) Dr.Sh. 3 (tre)

[Evidenca 31-33]

Për realizimin e programit Bsc në “Teknikë laboratorit në Mjekësi”, janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. Institucioni nuk referon staf ndihmës akademik me karakter mësues/laborant me formim të duhur profesional. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur lista e stafit akademik të përfshirë në realizimin e programit mësues në këtë program studimi, formimi i tyre profesional, vërtet për vitin akademik eksistues 2020-2021.

Stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit Bsc TLM është:
Viti 2020-2021: 19(nëntëmbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 14 (katërbëdhjetë) janë Staf PAE dhe 5(pesë) PAK . Nga stafi PAE 2 (dy) profesor, 1(një) prof.ass ,2(dy) doktorë shkencash, dhe 9(nëntë) Msc. Stafi PAK me kontratë 1 (një) Proff ,Ass , 2(dy) doktorë shkencash dhe 2(dy) MSc.

GVJ nuk i janë vënë në dispozicion lista të stafit që ka mbuluar programin gjatë viteve të mëparshme akademike dhe nuk mund të vlerësojë saktësisht strukturën akademike dhe cilësinë e mësuesve gjatë tërë periudhës së studimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi Planin mësues dhe Cv të stafit akademik, GVJ kostaton se ka pedagogë që japin lëndë të tipologjive të ndryshme apo që nuk përputhen me formimin e tyre profesional/specialitetin. Psh pedagog me formim në Bioteknolog zhvillon lëndën e mikrobiologjisë, imunologjisë, hematologjisë. Pedagog me formim mjekësi psikiatër i përgjithshëm zhvillon lëndën e hematologjisë, Histologjisë. Pedagog me formim infermier i përgjithshëm zhvillojnë fispatologji, Kimistë industriale zhvillojnë Biokimi të Aplikuar humane etj.

	<p>Gjithashtu institucioni nuk ka përmbushur kërkesat e Ligjit të Arsimit të lartë, sipas të cilit të gjithë Lektorët duhet të jene të paktën me graden Doktor i Shkencave.</p> <p>Referuar evidencës mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik konstatohet se pjesa më e madhe e ngarkesës mësimore 81 % realizohet nga stafi akademik efektiv.</p> <p><i>GVJ evidenton mospërputhje ndërmjet ngarkesës totale të stafit akademik 2182 orë në auditor (Referuar dok Ev.4) dhe ngarkesës mësimore referuar planit mësimor (Referuar dok shtesë, Ev.3) 2234 orë në auditor.</i></p> <p><i>GVJ bazuar në konstatimet e mësipërme rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve pedagogëve sipas formimit të tyre profesional dhe grupimi sipas tipologjive të ngjashme dhe angazhimin e lektoreve me grade shkencore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe dokumentave shtesë pas vizitës në institucion, konstaton se departamenti zotëron, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore [Ev 8, rregullorja e programit të studimit]. Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit, planet mësimore, orarin mësimor, kalendarin e provimeve, strukturën e vitit akademik.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura programi i studimit Bsc TLM përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018“ Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 3 vite akademike të ndara në 6 semestra. Numri i ETC është 60 ETC për çdo vit akademik, në total 180 ETC.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike	Bazuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Staf», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, veprimtaritë formuese, të programit realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara si më poshtë :
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>a) Lëndë bazë me 26 ETC (14%) b) Lëndë karakterizuese 96 ETC (53%) c) Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 21 ETC (11%) d) Lëndë plotësuese 27 ETC (15%) e) Detyrime përmbyllëse 10 ETC (5%)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Teknik laboratorë në Mjekësi realizon 37 module dhe kryhen 37 provime për kontrollin e dijeve të fituara nga student. Programi i studimit realizohet në leksione, seminare, praktika mësimore dhe profesionale si dhe për çdo modul/lëndë është i vlerësuar me ETC përkatëse.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Teknike, ku realizohet ky program studimi përmbajnë informacionin lidhur me planin mësimor të programit, ngarkesën mësimorë, ndarjen në leksione, seminare, praktika mësimore dhe profesionale si dhe ETC përkatëse për çdo lëndë, orarin e mësimor dhe auditorin ku kryhet lënda përkatëse, ndarjen e orëve sipas semestrave, orët brenda dhe jashtë auditorit të ndarë sipas viteve akademike. Rregullat lidhur me frekuentimin e programit nuk janë të përcaktuara në asnjë nga rregulloret e institucionit, por janë të përcaktuara në cdo syllabus lëndë: leksionet janë të detyrueshme të frekuentohen në masën 60% ndërsa seminare/ushtime 75% , ndërsa praktika laboratorike/profesionale 100%. Në syllabuse përcaktohet gjithashtu edhe mënyra e vlerësimit të studentit, realizimin e provimeve, praktikës profesionale etj. [Ev. 8,9,13,37,39,40. plani mësimor, orari i realizimit të ngarkesës mësimore, rregullorja e programit, syllabuset].</p> <p><i>GVJ konstaton se ka një mospërputhje të shifrave e frekuentimit për leksionet dhe seminarin në rregulloren e përgjithshme të IAI FSHMT me syllabuset. GVJ rekomandon korrigjimin eventual të shifrave në rregulloren e programit të studimit.</i></p> <p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit Në takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion e duhur , institucioni nuk ka kriteret specifike përzgjedhëse në pranime të vendosur me VKM. [Ev8. Rregullorja e Programit TLMFSHP, takimi me studentët].</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Teknike ku realizohet ky program studimi, përmbajnë informacionin lidhur me syllabuset që zhvillon në programin BSC TLM . Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen</p>

	<p>në leksione, seminare, praktikë mësimore/profesionle, ETC përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse. [programi studimit, syllabuset].</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton :</p> <ul style="list-style-type: none"> - syllabuset janë organizuar/formatuar kryesisht në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. - në shumicën e syllabuse titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor sipas Ligjit80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë’ neni 58 “Statusi i personelit akademik”. -në shumicën e syllabuseve nuk janë evidentuar temat e seminare krahas temave të leksioneve. -Në të gjitha syllabuset nuk janë vënë numrat e faqeve ë literatures në cdo temë leksioni. -literatura është e vjetëruar dhe disa herë e papërshtashme me lëndën. Ne rekomandojmë, mqs profili i studimit është specifik , që pedagogët e lëndëve bazuar në literaturën bazë, të përpunojnë leksione të dedikuara dhe të botuara apo shtypura zyrtarisht nga vetë institucioni. <p>GVJ bazuar në konstatimet e mësipërme rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe të literaturës së syllabuseve.</p> <p>Programi nuk ka rregullore të dedikuara në lidhje për praktikën profesionale ku të përfshihen udhëzime lidhur me realizimin e saj, kompetencat e fituara nga studenti, mënyra e vlerësimit etj.</p> <p>Programi i studimit Bsc Teknike Laboratori në Mjekësi, nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga momenti i licensimit, GVJ gjatë konsultimit me dokumentacioni dhe gjithashtu gjatë takimit me stafin dhe drejtuesit , nuk konstatoi procedura të qarta me qëllim përmirësimeve/ndryshimeve të programeve të studimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit bazuar në legjisllacionin në fuqi është organizuar në 3 vite akademike, me kohë të plotë , i organizuar në 6 semestra, 180

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>ETC, nga 60 ETC çdo vit akademik. Një semestër zgjat 15 javë kalendarike. Në fund të programit të studimit studenti i jepet diploma Bsc Teknik Laboratori në Mjekësi. Studenti diplomohet me provim formimi, nuk u evidentua mbrojtja e mikrotëzës si në takimin me stafin ashtu dhe në takimin me studentët. <i>Gjithashtu theksojme se ne programin e venë në dispozicion nuk bëhet ndarje semestrale, por programi është i ndarë vetem sipas viteve akademike. Nuk është e qartë cilat lënde behen në semestrin e parë dhe cilat në të dytin për të vlerësuar si ngarkesën mesimore semestrale dhe po ashtu dhe shpërndarjen e e ngarkesës si në orë ashtu dhe në disiplinë sipas pedagogëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe aftësisimit profesional.</p>	<p>Ndarja në kategori (A në F) dhe ngarkesa në krediteve (në%) për veprimtaritë formuese përputhet me VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” [dosja e programit]. Në total programi ka 180 ETC/4688 orë mësimore prej të cilave 2234 orë mësimore në auditor dhe 2454 orë ose 52.3% jashtë auditorit, punë e pavarur nga studentët. Në programin mësimorë një vënd të rëndë sishëm zë praktika profesionale me 535 orë në total në tre vite akademike. Ngarkesa mësimore javore është 20-25 orë. 1 ETC është 25 orë mësimore [Plani mësimor i programit]. Forma e mësimdhënies janë leksione, seminare dhe praktikë profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite/orë mësimore. Në tre vite akademike janë 985 orë leksione, 391 orë seminare, 420 orë laboratore, 435 orë praktika profesionale [plani mësimor 2018-2021].</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Proçesi mësimor zhvillohet në bazë kursit dhe grupi sipas kriterëve të miratuar nga MARS grupet e leksioneve 80-100 studentë, seminare 40-50 studentë, laboratorët 8-15 studentë, praktika mësimore 25-30 studentë, praktika profesionale 30-50 studentë. Ora mësimorë është 60(50+10)minuta. Orari mësimor dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga njësia bazë dhe miratohet nga titullari i institucionit. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program dhe departament. GVJ konstatoi së 81 % e programit mësimor realizohet nga PAE [plani mësimor, ngarkesa mësimore e pedagogëve].</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të teknikave të mjekësisë laboratorike, të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit, por GVJ evidentoi bazë laboratorike të munguar dhe gjithashtu mendon se në organizimin e lëndëve ka vend për përmirësim. Gjatë takimit me stafin dhe student u deklarua se studentet e bëjnë praktikën pranë institucioneve shëndëtsore, por <i>GVJ mendon se kjo praktikë ka tjetër fokus dhe nuk zëvendëson në asnjë moment orët</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Proçesi mësimor zhvillohet në bazë kursit dhe grupi sipas kriterëve të miratuar nga MARS grupet e leksioneve 80-100 studentë, seminare 40-50 studentë, laboratorët 8-15 studentë, praktika mësimore 25-30 studentë, praktika profesionale 30-50 studentë. Ora mësimorë është 60(50+10)minuta. Orari mësimor dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga njësia bazë dhe miratohet nga titullari i institucionit. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program dhe departament. GVJ konstatoi së 81 % e programit mësimor realizohet nga PAE [plani mësimor, ngarkesa mësimore e pedagogëve].</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të teknikave të mjekësisë laboratorike, të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit, por GVJ evidentoi bazë laboratorike të munguar dhe gjithashtu mendon se në organizimin e lëndëve ka vend për përmirësim. Gjatë takimit me stafin dhe student u deklarua se studentet e bëjnë praktikën pranë institucioneve shëndëtsore, por <i>GVJ mendon se kjo praktikë ka tjetër fokus dhe nuk zëvendëson në asnjë moment orët</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të teknikave të mjekësisë laboratorike, të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit, por GVJ evidentoi bazë laboratorike të munguar dhe gjithashtu mendon se në organizimin e lëndëve ka vend për përmirësim. Gjatë takimit me stafin dhe student u deklarua se studentet e bëjnë praktikën pranë institucioneve shëndëtsore, por <i>GVJ mendon se kjo praktikë ka tjetër fokus dhe nuk zëvendëson në asnjë moment orët</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të teknikave të mjekësisë laboratorike, të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit, por GVJ evidentoi bazë laboratorike të munguar dhe gjithashtu mendon se në organizimin e lëndëve ka vend për përmirësim. Gjatë takimit me stafin dhe student u deklarua se studentet e bëjnë praktikën pranë institucioneve shëndëtsore, por <i>GVJ mendon se kjo praktikë ka tjetër fokus dhe nuk zëvendëson në asnjë moment orët</i></p>

laboratorike të zhvilluara në laboratorët mësimore.

GVJ do të rekomandonte riorganizim dhe përditësim të programit, fenomen i cili nuk ka ndodhur që nga momenti i licensimit.

Kështu konkretisht sugjerojmë që :

- Biokimia të zhvillohet si lëndë me vetë që ne vitin e parë, pas zhvillimit të Kimisë dhe Biologjisë, ndoshta në semstrin e dytë.
- Lënda Kimi dhe Biokimi e Zbatuar duhet te ndahet, në bazë të syllabusit vihet re një mos lidhje organike mes temave, studenti s'mund të mësojë Biokimim të Zbatuar pa mësuar Biokimi Bazë.
- Teknikat në Endokrinologji nuk mund të jëtë lëndë më vetë, të bashkohet me Teknikat biokimike apo imunologjike.
- Të futet si lëndë mjekësia Transfuzive, e cila sot ka dhe Specializim me vete të Mjekëve si një fushë shumë e rëndësishme.

Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ECTS ju mundëson kryesisht studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten përgjithësisht të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre **[Takimi me studentët]**.

Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin Bsc "Teknikë Laboratori në Mjekësi". Në vitin e parë zhvillohen lëndë të formimit të përgjithshëm dhe bazë në shkencat mjekësore. Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë të formimit profesional sipas specialiteve. Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit profesional **[programi i studimit/planimësimor]**. Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se përpilimi i programit është bazuar në programin e Universitetit Shtetëror, **GVJ nuk gjeti evidenca të konsultimit me programe të tjera apo programe ndërkombëtare.**

Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjislacionin në fuqi, ngjashmëria e programit me programe në IAL të tjera, ndikon në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Megjithatë në takimin me pedagogë dhe studentë nuk u referua për mobilitet të asnjë prej studentëve në këtë program studimi.

GVJ nuk evidentoi praktika konkrete në lidhje me rishikim e vazhduar të programit dhe të literaturës, sic u theksua dhe më lart programi nuk ka pësuar ndryshime që nga momenti hapjes dhe literatura në syllabuse është e vjetëruar.

Përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e teknikave në mjekësinë laboratorike, aftësimin profesional teorik dhe praktik.

	<p>Përmbajta e programit i shërben studentëve për fitimin e njohurive bazë dhe thellimin e njohurive të përftuara në ciklin e parë të studimit në kualifikime të mëtejshme. Realizmi i programit bën të mundur përfitimin e shprehive dhe aftësive të duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre. Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që ju siguron studentëve informacionin e duhur për formimin e tyre profesional në ushtrimin e profesionit të teknikut të laboratorit në shërbime të ndryshme të mjekësisë laboratorike dhe përshtatjen e tyre me tregun e punës. [rregullorja programit, plani mësimor, orari mësimor].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbashin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin Bsc Teknik Laboratori në Mjekësi përmbush pjesërisht kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Ai përbëhet pjesërisht nga pedagogë me eksperiencë që kanë kualifikimin e duhur profesional për lëndët përkatëse që zhvillohen në program.</p> <p>Kategorizimi i pedagogëve në lektorë, asistentë lektor apo titullarë lëndë nuk është bazuar kërkesat e ligjit të arsimit të lartë pasi një pjesë e konsiderueshme e lektoreve janë të nivelit Master Shkencor. Konkretisht nga 19 lektore të cilët mbulojnë këtë program , 4 (katër janë të kategorisë profesor, 4(katër) me gradën Doktor i Shkencave, dhe 11(njëmbëdhjetë) janë të nivelit master. Gjithashtu vetëm një pjesë e vogël e titullareve të lëndëve janë të kategorisë Profesor. Gjatë bisedës më drejtuesit u deklarua se personeli i angazhuar në programet e ciklit të parë realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me institucionin, bazuar në udhëzimin nr 37, datë 4.12.2018 për një ndryshim në udhëzimin Nr. 29, datë 10.9.2018</p>

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

“Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.


GVJ konstatoi se në kontratën e punës si me stafin e efektiv ashtu dhe me atë me kontratë nuk janë të pasqyruar ngarkesa mësimore dhe lëndët që zhvillon pedagogu në programin e studimit me qëllim vlerësimin e menyrës së realizimit të ngarkësës mësimore, por në bazë të dokumentit të Ngarkesës Mësimore të Stafit Akademik [Ev. 4, dok shtesë], GVJ vlerëson se një pjesë e pedagogeve zhvillojnë më shumë se tre lëndë, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit të arsimit të lartë dhe gjithashtu kanë një ngarkësë të lartë mësimore.

Personeli akademik efektivë dhe me kontratë që angazhohen në për realizimin e programit të studimit, angazhohet seriozisht dhe përpiqet të realizojë objektivat pavarësisht ndonjëherë formimit jo të përputhshëm akademik me lëndët të cilat mbulojnë. **Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në programin e studimit:** 19(nëntëmbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 14 (katëmbëdhjetë) janë Staf PAE dhe 5(pesë) PAK. Nga stafi PAE 2 (dy) profesor, 1(një) prof.ass ,2(dy) doktorë shkencash, dhe 9(nëntë) Msc. Stafi PAK me kontratë 1 (një) Proff ,Ass , 2(dy) doktorë shkencash dhe 2(dy) MSc.

<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p><i>GVJ bazuar në konstatimet e mësipërme rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve pedagogëve sipas formimit të tyre profesional dhe grupimi sipas tipologjive të ngjashme dhe angazhimit të lektoreve me grade shkencore.</i></p> <p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë pjesërisht në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve. <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si planit mësimor, ngarkesa mesimore sipas stafit akademik dhe Cv të stafit akademik, GVJ kostaton se ka pedagogë që japin lëndë të profiëve të ndryshme apo që nuk përputhen me formin tyre profesional/specialitetin; psh pedagog me formim në Bioteknologji zhvillon lëndën e mikrobiologjisë , imunologjisë, hematologjisë. Pedagog me formim mjek psikiatër i përgjithshëm zhvillon lëndën e hematologjisë, Histologjisë. Pedagog me formim infermier i përgjithshëm zhvillojnë fispatologji, Kimistë industriale zhvillojnë Biokimi të Aplikuar humane etj. GVJ evidenton një mungesë të theksuar të pedagoqeve me formin e duhur profesional apo specialitetin përkatës sidomos në lëndët karakterizuese të pogramit, lëndë të cilat formojë profesionalisht Tekniket e Laboratoreve Mjekësore. Ky është një program i cili diplomon teknik të laboratorëve mjekësore në katër drejtime kimi klinike, hematologji, mikrobiologji dhe anatomi patologjike, dhe si personel akademik ka vetëm një mjek specialist në Laborator Biokimik –Klinik, asnjë mikrobiolog, asnjë anatomopatolog. Në bazë të legjislacionit Shqiptar nga tërë stafi akademik vetëm dy prej tyre mund të janë personel shëndëtsor i licensuar në laboratorët mjekësore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p><i>Gjithashtu institucioni nuk ka përmbushur kërkesat e Ligjit të Arsimit të lartë , sipas të cilit të gjithë Lektorët duhet të jene të paktën me gradën Doktor i Shkencave. Vetem një pjesë e vogël e moduleve kane titullarin të katëgorisë Profesor.</i></p> <p>Referuar evidencës mbi ngarkesën mesimore të stafit akademik konstatojmë se pjesa më e madhe e ngarkesës mesimore 81 % realizohet nga stafi akademik efektiv. Sic është theksuar dhe më lart : <i>GVJ evidenton mospërputhje ndërmjet ngarkesës totale të stafit akademik 2182 orë në auditor [Referuar dok Ev.4] dhe ngarkesës mesimore referuar planit mësimor [Referuar dok shtesë, Ev.3] 2234 orë në auditor.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mesimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale, Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione publike shëndetësore, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione. Institucion nuk demostroi praktika të dokumentuara për të gjithë procesin e informimit, akomodimit, angazhimit të personelit pritës, ndjekjes, vlerësimit, fitimit të kompetencave, verifikimit të angazhimit etj të studenteve në këtë institucionë. Programi nuk ka një</p>

	<p>praktikum të posacëm për zhvillimin e praktikës profesionale. Institucioni ka përpiluar një dokument të hollësishëm për mënyrën e përpunimit dhe ndërtimit të diplomës nga ana e studenteve, gjithashtu rregullorja e Instucionit përshkruan të gjitha kriteret e aplikimit, zgjedhjes së udheheqësit, zgjedhjen e temës, etapat e punës dhe mënyrën e mbrojtjes së diplomës. [Ev.6. 38. Rregullore e institucionit, Udhezuaes për mbrojtjen e diplomës].</p> <p>GVJ evidenton se opsioni i mbylljes së studimeve me mikrotezë nuk pëfshihej në rregullorën e programit dhe se asnjë nga student që diplomohen në këtë program në këtë vit akademik nuk kishtë marrë tëme diplome.</p> <p>Instucioni nuk ka laboratore te dedikuar për këtë program studimi dhe GVJ nuk evidentoi personel ndihmës akademik as në dokumentacion dhe as gjatë takimit me stafin dhe drejtuesit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Institucioni ka hartuar rregullore për funksionimin e tij, Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe programit të studimit të miratura nga titullari i institucionit [Ev.6,7,8,rregulloret]. Rregullorja e programit të studimit, përcakton elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	GVJ në takimin me stafin akademik dhe studentët konstatoi se në program e studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online bazuar në udhëzuesin për përdorimin e metodave të mësimdhënies dhe strategjine integritit dhe trajtimit të stafit të Kolegjit Universitar Reald. [Takimet me stafin dhe studentët, Evidenca 45. Google Classroom - Manuali për studentët, Evidenca 46. Manual për programin OBS për regjistrim Video dhe Audio, Evidenca 47. Google Classroom - Manual për pedagogun].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka në funksionim NJSBC e cila në bashkëpunim me Zv/ Rektorin për Proçesin mësimor, Dekanët, Drejtuesit e Departamentit dhe Sekretarinë mësimore kryhen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrative. Në mënyrë të vazhdueshme monitorohet procesi i mësimdhënies me anë të pyetësorëve të studentëve, të vetëvlerësimit të pedagogeve. GVJ shtimin e aplikimit të mekanizmave direkt si monitorimi i drejtpërdrejtë i mësimdhënies i praktikave mësimore hse i aktiviteteve shkencore të ersonelit akademik. [Evidenca 52. Rregullore e NjsBC, Evidenca 53. Formular NJSBC - Vleresim i studentit per pedagogun 2019-2020, Evidenca 54. Formular per Studentet - per vitin akademik 2019-2020, Evidenca 55. Formular vetevleresimi i pedagogut 2019 – 2020]. NJSBC monitoron dhe vlerëson në mënyre periodike proçesin mësimor, aftësitë e stafit akademik duke përfshirë dhe studentët në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve duke u bazuar në pyetësorin e studentëve. Studentët shprehin vlerësimet e tyre për proçesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në NJSBC dhe gjithashtu në grupin e punës për hartimin e RVB. [Evidenca 57. Miratim strukture NJSBC, Evidenca 1. Urdher i rektorit per GVB].
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	

	<p>NJSBC pas përpunimit statistikor të pyetësorëve nxjerr përfundimet e pyetësorit dhe bën rekomandimet përkatëse. Rezultatet për vlerësimin e dhënë nga studentët për çdo fakultet bëhen publike për të gjithë stafin dhe studentët në uestite të UV. Rezultatet dhe informacionet e marra nga sondazhet i shërbejnë përmirësimit të punës në institucion dhe të stafit akademik, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit të metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve.</p> <p>Gjatë takimit me stafin u evidentua mbështetja dhe inkurajimi nga ana e institucionit të personelit akademik për përmirësimin e metejshëm të cilësisë së mësimdhënies, duke promovuar gjithashtu shëmbuj të praktikave të mira nga ana e pedagogëve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në realizimin e procesit mësimor programi Bsc në “Teknik Laboratori në Mjekësi”, përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminarë, praktika profesionale, detyra kurse, projekteve [RBV, takime me stafin akademik, regullorja e programit Bsc TLM] . Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Power Point, biseda interaktive me studentët apo temave të veçanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin. [Rregullorja e TLM, Regullorja e programit të studimit] .
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Personeli akademik respekton diversitetin e nevojave të studentëve duke krijuar atyre mundësi reale të metodave alternative të mësimdhënies. Gjatë takimit me stafin dhe studentët u vu re se stafi reflekton një frymë të shëndetshme bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ndaj studentëve duke trajtuar me përgjegjësi çdo sugjerim apo ankesë nga ana e studentëve. Mendojmë që respekti i ndërsjellë dhe fryma e bashkëpunimit ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu institucioni nxit dhe mbështet pedagogët në përdorimin e metodave alternative dhe të shumëllojshme të mësimdhënies duke vënë në qendër studentin, nevojat e tij me qëllim arritjen e objektivave të formimit akademik në përputhje me nevojat e tregut të punës.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënies, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.	
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka pjesërisht përgatitjen profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencën mjekësorë apo pedagogjike në lëndët që zhvillojnë [CV e stafit akademik] . Gjatë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

tematikave dhe profilit.	takimit me stafin u evidentua se pedagoget përdornin metoda të ndryshme në funksion të secilës lëndë sic janë leksione me paraqitje me powr point, shkrim në tabelë, fotoprojektorë, seminarët ku një rëndësi i jepet pjesmarjes së studenteve në diskutime interaktive. Theksojmë përsëri se mungesa e laboratoreve specifike të fushës nuk krijon mundësinë e përfshirjes së studentëve në aplikimin e metodave laboratorike dhe mësimin praktik të procedurave laboratorike.			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ nga shqyrtimi i ngarkesës mësimorë të pedagogëve dhe planit mësimor konstatoi se ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	GVJ rekomandon rekrutimin e pedagogëve me formimin eduhur profesional dhe ndërtimin e laboratoreve mësimore mjekësore në institucion.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Stafi akademik tenton të përmirësoi format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Mendimi i studentëve në lidhje me metodat e mësimdhënies tërhiqet në përfundim të cdo semestri ku atyre nga NJSBC u shpërndahen pyetësor, dhe në një anonimat të plotë japin mendimet edhe sugjerimet e tyre lidhje me stafin akademik dhe përmirësimin e metodat e mësimdhënies. Këto të dhëna përpunohen nga NJSBC, e cila harton raportin përkatës, i cili u komunikohet titullarëve dhe në vartësi të vlerësimeve, sugjerimeve dhe konkluzioneve të arritura urdhërohet marrja e masave për të bërë përmirësimet e nevojshme. [Evidenca 58. Raport vjetor i NJSBC 2019-2020]. Personeli akademik për ta bërë tërheqëse orët e mësimi përdor metoda interaktive dhe diskutimin e rasteve, përdorimin e videoprojektorëve apo ushtrimeve të ndryshme të cilat janë më atraktive për studentin. Me interes për studentët janë diskutimi i rasteve kliniko laboratorike në Leksion apo seminarë. [Takimi me stafin akademik dhe studentët]. Metoda të tilla inkurajojnë studentin për të menduar vepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur, i japin studentit siguri në vëndimmarrjet teknike dhe klinike me të cilat do të përballen në të ardhmen, i japin atij sensin e autonomisë. Siguria profesionale dhe autonomia e studenteve në këtë program studimi do të rritej akoma më shume nqs ato do të kishin mundësinë e aplikimit direkt dhe në menyrë të pavarur të metodve dhe teknikave laboratorike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Institucioni ka siguruar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, të ajrosura dhe, të pajisura me sistem kondicionimi dhe ndriçimin e duhur. [vizita e ambienteve] Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë për zhvillimin e mësimin, tabela shkrimi të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies [të dhënat për infrastrukturë], [vizita e ambienteve] . Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve burime të ndryshme informacioni si internet, literaturë të shkruar, kompjutera, salla pune dhe leximi, [të dhënat për infrastrukturën] .
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Për të garantuar marrjen e dijeve në forma të ndryshme studentëve i jepet mundësia e shfrytëzimit të literaturës në gjuhën shqipe. Në takimin më stafin dhe studentët u deklarua se studentët mund të shfrytëzojnë leksionet e përgatitura nga pedagogët në formë hard copy ose elektronike, gjithashtu në bibliotekë kanë mundësi të shfrytëzojnë literaturën e huaj. Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj që përgjithësisht i përgjigjet temave të programit mësimor [format syllabusi], [syllabuset e lëndëve], GVJ evidenton se literatura bazë në syllabuse është e vjetëruar dhe rekomandon rinfreskimin e saj.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Institucioni ka në funksion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën e cila ka materiale në shqip dhe në gjuhë të huaj. Institucioni publikon listën e librave të rinj që hyjnë në bibliotekë, oraret e shfrytëzimit të ambienteve të bibliotekës nga studentët apo stafi akademik [vizita e ambienteve] . Institucioni duhet të sigurojë studentëve dhe pedagogëve mundësi aksesimi në librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë, biblioteka dhe laboratorit i informatikës janë të hapur çdo ditë nga 8.00 deri në orën 16.00.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni disponon laboratorë në funksion lëndëve bazë të programit mësimor Bsc në Teknikë Laboratori në Mjekësi, si laboratorit i informatikës, fizikës, laboratorit anatomisë, por sic e kemi theksuar më lart nuk ka laboratore të mjekësisë laboratorike. [të dhëna për infrastrukturën, vizita e ambienteve] . Gjithashtu, institucioni ka rregullorren për menaxhimin e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit në institucion të rishikuar sipas
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe	

hapësirën vetjake të dedikuar.	rekomandimeve të bordit dhe vendim të Senatit Akademik nr 34 datë 09.05.2020 miratur si dhe rregulloren. Nr,36, datë 01.06.2020.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>Nga takimet me stafin, studentët, sekretarinë dhe burimet njerëzore, rezultoi se institucioni ka në përdorim një sistem menaxhimi të informacionit, sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore, gjithashtu personeli akademik dhe studentët kanë sistem komunikimi të brendshëm me qëllim aksesimin e dokumentacionit elektronik dhe me hapësirë vetjake të dedikuar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe gjatë takimit me drejtuesit u evidentua se institucioni nuk ka një platformë të dedikuar në funksion të mësimdhënies online dhe në distancë. Për periudhën e pandemisë Covid 19 stafi akademik referon se mësimi është zhvilluar online me zoom dhe google classroom dhe me mbështetjen e vazhdueshme të stafit IT të fakultetit. [takimi me stafin akademi]</p> <p>Institucioni ka një rregullore për procedurën e zgjedhjes dhe miratimit të temës së diplomës dhe vlerësimin e saj [udhëzuesi për punimin e temës së diplomës]. Në rregullore përcaktohen gjithashtu monitorimi i fenomeneve të plagjizimit <i>por institucioni nuk disponon sisteme antiplagjature</i>. Sipas rregullores dhe takimit me stafin, temat e diplomës zgjidhen nga studentët në konsultim me pedagogët e tyre në mënyrë që temat të jenë në funksion të përgatitjes së tyre profesionale por <i>vumë re që në këtë program studimi asnjë nga studentet e vitit të fundit nuk kishte marrë temë diplome për mbylljen e studimeve</i>.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësinë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional, NJSBC [rregullore NJSBC]. Kjo njësi harton plan pune që miratohet nga Rektori i KUR dhe e ndjek atë në vitin pasardhës [plan pune NJSBC]. Gjatë takimit në institucion u deklarua se në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë zhvilluar leksione e hapura të organizuara nga departamentet në ditë të veçanta kombëtare të lidhura me shëndetin si dita e diabetit, hipertensionit, dhurimit të gjakut, talasemisë, etj. <i>Por GVJ evidenton se pjesëmarrja e studentëve të programit Teknik Laboratori në Mjekësi ka qënë pasive</i> . Këto aktivitete ndikojnë në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies por e rëndësishme
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë	

<p>përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>mbetet edhe përfshirja aktive e studentëve në këto aktivitete.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike është njësi përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programeve mësimore. Statuti i institucionit përcakton qartë detyrat e njësisë bazë në raport me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. [Ev.3 statuti i kolegjit universitar Reald] Gjithashtu në rregulloren e fakultetit janë të përcaktuara dhe përgjegjësistë dhe detyrat e Përgjegjesit të departamentit. Bazuar në diskutimet e kryera me drejtuesit e institucionit, departamentit dhe stafit akademik [takimi me drejtuesit], rezultoi se është bërë një punë e mire për të rritur vetë ndërgjegjësimin te personeli akademik në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni ka siguruar pjesërisht infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor dhe nuk ka laboratore për të realizuar praktikat laboratorike apo studime të avancuara, kërkime shkencor etj. GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për nxitur kërkimin shkencor të stafit akademik, këtij qëllimi i shërben dhe hartimi i një plani vjetor pune për kërkimin shkencor të miratuar nga senati akademik për vitin akademik 2020- 2021 me vendim nr 40, datë 8.12.2020. [Ev. 61 Plan pune për aktivitetin kërkimor shkencor].</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, konferenca apo rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit, realizimit të konferencave të përbashkëta me IAL brenda vendit apo jashtë, mbështetje me bursë për realizim të temave të doktoraturës në kuadër të projekteve të bashkëpunimit që kanë me institucione jashtë vendit realizimin e botimeve në buletin shkencor të fakultetit apo revista të tjera, brenda dhe jashtë vendit [takimi me stafin drejtues], [Ev 3. Dok shtësë Aktiviteti kërkimor shkencor], [Ev 62. Buletini Shkencor Reald]. GVJ vëren që aktivitetet në fushën e mjekësisë laboratorike janë pothuajse të munguara, kjo ndoshta për shkak dhe të pandemisë covid-19.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Institucioni i ka siguruar infrastrukturën fizike të nevojshme departamenteve për trajnim të stafit akademik për zbatimin e metodave inovative në mësimdhënie në bashkëpunim me strukturat drejtuese dhe departamentet e tjera të FSHM. Institucioni disponon infrastrukturën logjistike të bazuar në teknologji për aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies [vizita e ambienteve].</p> <p>Institucioni realizon takime apo konferenca të veçanta që shërbejnë për shkëmbim eksperience dhe shpërndarje të informacionit duke ftuar profesorë të huaj kryesisht nga Italia për tema të caktuara, seminare, konferenca, etj. Këto aktivitete i shërbejnë përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, por temat e trajtuara në këto</p>

	aktivitete nuk i përkisnin programit të studimit në fjalë. [takim me studentët dhe pedagogët gjatë vizitës në institucion] (Standardi III.4).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni ka përpiluar rregullore të posatshme në bazë departamenti për organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve, gjithashtu mënyra e zhvillimit të provimit, modalitetët e vlerësimit vjetor dhe të provimit përfundimtar, detajohen në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabusin e çdo lëndë, të gjitha procedurat bëhen publike dhe u komunikohen hollësisht studentëve. [rregullore e fakultetit, rregullore e zhvillimit të provimeve].			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabusin e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Mënyrat e informimit të studenve janë përmes venies në dispozicion të rregullores së programit, informimit nga shefi departamentit dhe kryesisht nga titullari i lëndës/modulit i cili i informon në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabusin e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të FSHM si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve [plani mësimor, [dosja e programit].			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi bëhet gjatë tërë vitit ku 40% merret gjatë vitit me ane të provimeve të pjesshme, detyrave të kursit, aktivizimit etj dhe 60% në provimin përfundimtar. Testimi i dijeve dhe aftësive profesionale bëhet mbi bazë e sistemit të notave ku nota minimale është 5 dhe maksimalja nota 10. Vlerësimi bëhet me shkrim ose me gojë në varësi të syllabusit përkatës. Mënyra e vlerësimit ju komunikohet studentëve në fillim të procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i	Vlerësimi i studentit bëhet gjatë tërë zhvillimit të lëndës apo modulit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>dhe jo vetëm në fund të programit mësimor. Konkretisht :40% e vlerësimit bëhet gjatë zhvillimit të lëndës, nga të cilat 10% i dedikohet aktivizimit dhe 30% zhvillimit të provimit të ndërmjetëm; provimi përfundimtar zë 60% të vlerësimit të përgjithshëm. Procedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores “Për zhvillimin e provimeve të miratuar nga senati” [rregullore e provimeve].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni nuk përdor sisteme elektronike të testimit në këtë program studimi dhe as në programe të tjera, gjatë takimit me stafin dhe drejtusit u deklarua se për të menjanuar abuzimet dhe rritur transparencën në të gjitha sallat janë instaluar kamera dhe në rastë komprometimit të tëzës përgjegjësia i kalon direkt e pedagogut të lëndës.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Provimi zhvillohet nga dy pedagogë, njëri prej të cilëve është pedagogu i lëndës. Testimi i dijeve kryhet me shkrim dhe në mënyrë anonime me sekretim. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë dhe komisionit të provimit, sekretarja identifikon studentët dhe bën procesin e sekretimit. Në pjesën e pasme të fletës së provimit janë të shënuara kriteret e vlerësimit. Procesi i kodimit zhvillohet pas korrigjimit të tezave nga sekretarja bashkë me pedagogun. Vendi dhe ora e provimit shpallen një muaj para, dorezimi i tezave të firmosura nga pedagogu i lëndës bëhet 30 minuta para fillimit të orarit zyrtar. Gjatë vizitës në institucion, GVJ përzgjedhi me sondazh flete provimi dhe konstatoi se fletët e provimit ishin korekte dhe të firmosura nga pedagogët që kishin realizuar provimin. [takimi me sekretarinë mësimore].</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Procesi i vlerësimit nëqoftëse është e nevojshme shoqërohet me komente në raste paqartësish nga ana e studentëve me qëllim përmirësimin në të ardhmen. Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Komisioni i vlerësimit mbledh kërkesat e studentëve dhe pas rishikimit të fletës së provimit cakton një datë për të biseduar me studentët. Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë apo komunikimi midis studentëve. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve [takimi me studentët]. Për çdo provim, pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedurës së miratuar në rregulloren përkatëse të provimit. Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit dhe kryhet sipas rregullores përkatëse. Procedura e ndjekur për çdo ankese apo rishikim dokumentohet dhe arkivohet në</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve [takimi me studentët]. Për çdo provim, pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedurës së miratuar në rregulloren përkatëse të provimit. Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit dhe kryhet sipas rregullores përkatëse. Procedura e ndjekur për çdo ankese apo rishikim dokumentohet dhe arkivohet në</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve [takimi me studentët]. Për çdo provim, pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedurës së miratuar në rregulloren përkatëse të provimit. Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit dhe kryhet sipas rregullores përkatëse. Procedura e ndjekur për çdo ankese apo rishikim dokumentohet dhe arkivohet në</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve [takimi me studentët]. Për çdo provim, pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedurës së miratuar në rregulloren përkatëse të provimit. Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit dhe kryhet sipas rregullores përkatëse. Procedura e ndjekur për çdo ankese apo rishikim dokumentohet dhe arkivohet në</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve [takimi me studentët]. Për çdo provim, pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedurës së miratuar në rregulloren përkatëse të provimit. Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit dhe kryhet sipas rregullores përkatëse. Procedura e ndjekur për çdo ankese apo rishikim dokumentohet dhe arkivohet në</p>

	institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit të ciklit të parë Bsc në “ Teknikë laboratorit në Mjekësi” është 3 vite akademike, 6 semestra dhe ka 180 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore = 50 minuta. 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit tenton të paisë studentët me njohuri të formimit të përgjithshëm me anë të trajtimit të disiplinave të shkencave të natyrës, njohuri të shkencave mjekësore dhe teknikave bazë laboratorike duke i mundësuar përfundimin e njohurive profesionale, teknike dhe interpretative të parametrave të ndryshëm të cilët vlerësohen në mjekësinë laboratorike. Në përfundim të studimeve të ciklit të parë të studimeve, studentët pajisen me diplomë Bachelor, me emërtimin Bachelor në “ Teknike Laboratorit në Mjekësi”. Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit, studimet mbyllen me provim përfundimtar. Diploma i jepet studentit që ka kryer të gjitha detyrimet e programit mësimor dhe janë vlerësua pozitivisht në provimin përfundimtarë.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike me qëllim realizimin e egzaminime laboratorike me cilësi dhe saktësi. Gjithashtu programi përfshin lëndë të cilat rrisin aftësinë e studenteve në teknologjinë e informacionit, fushë kjo shumë e rëndësishme sidomos me zhvillimet e vullshme të sistemeve të informatizimit në mjekësinë laboratorike. GVJ identifikoi kapacitete të mjaftueshme [salla e lab IT] ku studentët mund të përdorin teknologjinë dhe të praktikojnë njohuritë e tyre.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Dijet e marra, aftësitë dhe kompetencat e përfituara gjatë realizimit të programit të studimit vlerësohen në përfundimin e lëndëve përkatëse me sistemin e notave ku nota 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale. Në përfundim të programit të lëndës, pedagogu organizon një përmbledhje të temave dhe çështjeve të diskutuara dhe orienton studentët për provimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të tij dhe vlerësimit të dijeve [takimi me studentët] [takimi me stafin].
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarit të promocionit shëndetësor, institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Në këto aktivitete ftohen dhe lektorë të huaj të cilët zhvillojnë leksione të hapura në gjuhë të huaj, që asistohen me përkthyes. Institucioni nuk disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve [takimi me studentët], [takimi me stafin].			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në programin Bsc në “ Teknikë Laboratori në Mjekësi” janë angazhuar pedagogë me kontratë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. <i>Sic është theksuar në këtë raport një pjesë e lëndëve zhvillohen nga pedagogë ku fusha e ekspertizës nuk përputhet me syllabusin e lëndës, duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies.</i> Programi i studimit është specifik dhe bazohet kryesisht në punën individuale të studentit me qëllim fitimin e kompetencave tek studenti, <i>GVJ vlerëson se mungesa e laboratoreve mjekësore në institucion , pamundësia për të mësuar praktikisht metodat laboratorike ka dëmtuar forminin profesional dhe fitimin e kompetencave tek studentët.</i></p> <p>Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet studentët në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon KUR, temave të kursit, projekte si dhe gjatë kryerjes së praktikës profesionale në institucione shëndetësore [takimi me studentët]. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion logjistikën, bibliotekën e KUR, asistencën nga stafi akademik, si dhe ka akorduar dhe një buxhet të vecantë për këshillin studentor për vitin 2019- 2020 të miratuar me vendim të senatit Akademik.</p> <p>Në takimin me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se kanë si objektiv realizimin e programeve të përbashkëta me institucione jashtë vendit si Italia, dhe rritjen e mobilitetit por në programin e studimit Bcs Teknike Laboratori në Mjekësi nuk ka asnjë student që ka shkuar në universitete të huaja. Gjatë takimit me studenteët u vu re interes i ulët i tyre për mobilitet në instucione të tjera të arsimit të lartë. Në këtë drejtim, <i>GVJ rekomandon që institucioni të vërë në zbatim marrëveshjet e nënshkruara me partnerët e huaj për të rritur mobilitetin e stafit dhe studentëve të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studenti në fund të studimeve pajiset me diplomë Bsc në “Teknik Laboratori në Mjekësi” pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor ka dhënë provimin final ose ka mbrojtur mikrotezën. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e diplomimit të miratuar me vendim të senatit akademik [rregullorja e diplomimit] . Institucioni ka përgatitur një udhëzues i cili mbart informacionetë detajuara për mënyrën e shkrimit dhe realizimin e temës së diplomës [udhëzuesi i hartimit të diplomës] .
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Bazuar në udhëzuesin e hartimit të diplomës, në realizimin e temës së mikrotezën studentët asistohen nga pedagogët, ndihma e të cilëve konsiston në zgjedhjen e temës së diplomwë, hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, prezantim e materialit, etj. Udhëheqësi i temës garanton vërtetësinë dhe cilësinë e rezultatit dhe jep miratimin për paraqitjen e temës në komisionin e vlerësimit. Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara jurisë së komisionit të ngritur nga Dekani i fakultetit, e cila e vlerëson studentin me notë, bazuar në punën e tij dhe vlerësimin e udhëheqësit të temës. [EV 38. Udhëzuesi për punimin e temës së diplomës]. Por si është përmendur dhe më lart asnjë nga studentët e vitit të fundit nuk ka marrë temë diplome për mbylljen e studimeve. Në rregullore përcaktohen edhe termat për kontrollin e plagjaturës, por instucioni nuk disponon sistem antiplagjaturë.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studenti mbron diplomën me provim final pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Ky testim bazohet në njohuritë e marra gjatë të tre viteve të programit të studimit duke përfshirë lëndët në bazë të peshës specifike të tyre në program. Vlerësimi në provimin përfundimtar kryhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3-5 vetë të miratuar nga dekani i fakultetit [Ev 6 Rregullorja e përgjithshme e IAL] . Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës eksperimentale të temës së diplomës kabinetet dhe laboratorët mësimor si dhe ju garanton studentëve mbledhjen e të dhënave apo realizimin e testeve të ndryshme në funksion të temës në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi [Ev.19 Marrëveshjet bashkëpunimi] .
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Studenti pajiset me diplomë, suplementin e diplomës dhe një kopje zyrtare të programin mësimor pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj KUR. [Ev.65,43,9, Modeli i diplomës. Suplementi i diplomes. Programi mësimor] Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet [Ev. 66 Rregullore e sekretarisë mësimore] .
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësish shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se KUR disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit bachelor “Teknik Laboratori në mjeksi”, koordinatorin për organizimin e programit të studimit, i cili është PAE. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik [dosje personeli].</p> <p>Institucioni (koordinatori i programit) disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, ngarkesën e tyre mësimore si dhe personelin administrativ. [ngarkesa mësimore], [orari mësimor], [CV të stafit të dorëzuara].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik nënshkruan kontrata vjetore me afat të caktuar si për stafin akademik efektiv dhe atë me kontratë. Në kontratën e punës nuk janë të pasqyruar departamenti apo programi i studimit ku është angazhuar pedagogu si dhe ngarkesa mësimore e pedagogut. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Ata referuan se pagesa e personelit akademik bëhet në bazë të ngarkesës mësimore që realizojnë. [takimi me stafin akademik; kontrata të personelit PAE/PAK].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të qartë për kategorizimin e personelit akademik sipas përcaktimeve të LAL dhe Udhëzimit 29 të MASR për ngarkesën mësimore në IA të miratuar nga Rektori i KUR. GVJ rekomandon që në kontratën individuale të punës të përcaktohet departament apo program është punësuar pedagogu si dhe ngarkesa</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

mësimore që ai realizon në vitin akademik. Institucioni të shohë mundësinë e kategorizimit të kontratave të punës në përputhje me Udhëzimet e MASR, Kodin e Punës dhe aktet e veta rregullatore, por njëkohësisht të marrë parasysh përcaktimet ligjore të ligjit të arsimit të lartë në lidhje me kategoritë e personelit akademik në IAL (Standardi IV.1). Këto masa mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë për kategorinë PAE.

Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, GVJ, u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK dhe pedagogë të ri me kontratë. GVJ verifikoi me sondazh dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë. Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga KUR [procedurë rekrutimi për personelin]. Kontratat rinovohen për çdo vit akademik. Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga KUR.

Rekrutimi i stafit akademik bazohet në aktet ligjore në fuqi. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit [procedurë rekrutimi për personelin]. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik; procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi [takimi me drejtuesit; takimi me burimet njerëzore].

Në dosjet e personelit apo në dokumentet e vëna në dispozicion nga ana e institucionit (për këtë program studimi) janë përfshirë pjesërisht elementët e Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i cili përcakton mekanizmat për llogaritjen e ngarkesës vjetore të punës për personelin me kohë të plotë e të pjesshme sipas kategorive të personelit akademik [kriteret e shpërndarja e ngarkesës]. Nga shyrtimi me sondazh i dosjeve të personelit GVJ konsttoi se është i pranishëm dokumentacioni i kërkuar si CV, deshmi të kualifikimeve, kontrat e punës, kartë identiteti, diploma e studimeve, lista e notave, shkresa emërimit, kontarta e punës, listë botimeve, certifikaa e titullit apo grada shkencore që zotëron.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	KUR ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin e KUR me qëllim kryerjen në mënyrë profesionale të detyrave të tyre [dok. nr 34. Të dhëna për infrastrukturën] . Nga takimi me personelin akademik, personeli shprehet se Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre. Institucioni mbështet dhe siguron që një pedagog i këtij programi të kryej doktoraturën në rumani [takimi me stafin] .								
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni deklaron se ka kryer aktivitete shkencore dhe leksione të hapura, pjesëmarrje të stafit akademik dhe studentëve në aktivitetet shkencore kombëtare apo vizita shkëmbim eksperience me institucione analoge në Itali në funksion të kualifikimit profesional të personelit akademik. Aktivitetet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional, për njohjen e stafit me teknologjitë e reja dhe zbatimin e tyre në procesin mësimor deklarohet se zhvillohen, por për shkak të pandemisë covid 19 këto dy vite këto aktivitete kanë qënë të pakta. Një vënd të rëndësishëm në këtë periudhë ishte përshtatja e stafit akademik dhe studentëve me metodat e mësimit online. Gjatë takimit me pedagogët u theksua ndima dhe mbështetja e stafit akademik nga institucioni dhe vecanërisht nga sektori IT për përdorimin e platformave on line të mësimdhënies. [takimi me stafin,- takimi me studentët] .								
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Drejtuesit e institucionit u shprehën gjatë vizitës në institucion se hasin vështirësi në rekrutimin e personelit të kualifikuar në këtë program studimi [takimi me drejtuesit] . Vështirësia lidhet me numrin e vogël të specialistëve në rajonin e Vlorës dhe pamundësinë e rekrutimit të stafit nga qytetet e tjera për shkak të largësisë fizike.								
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë	Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët, janë të përshtatshme për zhvillimin e një

<p>mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>procesi normal mësimor. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimorë, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking.</p>										
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohje qendrore, sistem sigurimi pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyjehidrosanitare, sistem të mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion [të dhëna për infrastrukturën]. GVJ vizitoi auditorët mësimorë të cilat ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Këtë vit akademik institucioni ka zgjeruar kapacitetin pritës me ambiente të reja (kati -1) në të njëjtën godinë. KUR ka vënë në dispozicion të procesit mësimor 2 laboratorë dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimeve [vizita në ambiente].</p>										
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni disponon laboratorë mësimorë dhe kabinete në funksion direkt të zhvillimit normal të programit mësimor, si laborator i anatomisë, fizikës, informatikës dhe kimisë, <i>por si u theksua edhe më lart nuk disponon laboratorë mjekësorë për realizimin e praktikave lëndore që realizohen në këtë program studimi</i>. Laboratorët mësimorë përmbajnë aparaturat dhe mjetet e tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit [të dhëna për infrastrukturën]. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me video projektor dhe me pajisjet e tjera të nevojshme [vizita e ambienteve]. Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit.</p>										
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit KUR ka në zbatim marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor [marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtare]. Nga stafi drejtues dhe studentët u theksua se për shkak të mungesës së laboratorëve mjekësor mësimor në këtë program studimi, praktika lëndore është zhvilluar në laboratorët dhe institucione shëndetësore më të cilat KUR ka marrëveshje [takimi me stafin akademik dhe studentët].</p>										
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="606 1809 751 1877">Shkalla e përmbushjes së standardit</th> <th data-bbox="751 1809 943 1877">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="943 1809 1129 1877">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1129 1809 1378 1877">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>			Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht								
	X										

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sallë biblioteke të pajisur me 20 vende leximi dhe vendi interneti të pajisura me kompjutera. Biblioteka disponon 2500 botime/titujsh librash profesional. Stafi akademik dhe studentët dispononin adresa të brendshme email-i [rregullore e menaxhimit të sistemit të informacionit].</p>			
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. Në bibliotekë arkivohen kopjet e revistës së botuar nga ana e institucionit dhe periodikë të tjerë [vizita e ambienteve].</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p><i>Institucioni duhet të krijojë kushte për akses në bibliotekat on-line të fushës së mjekësisë të cilës i përket dhe programi i studimit (Standardi IV.4).</i> Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u deklarua se KUR e pasuron çdo vit bibliotekën me literaturë mjekësore dhe jo mjekësore, bashkëkohore, të cilat bëhen publike për stafin dhe studentët. GVJ konstatoi se institucioni ka shtuar 500 librat në fondin me 42 tituj të rinj ku 14 tituj janë në fushën e mjekësisë në ndihme të këtij program studimi [lista e librave të rinj]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në dokumentacionin mbështetës, institucioni ka paraqitur një dokument i cili tregon mekanizmat e ruajtjes dhe administrimit të informacionit në KUR lidhur me studentët nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre [rregullore e menaxhimit të informacionit, rregullore e administrimit të dokumentacionit].			
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili të funksionojë në bazë të rregullores të sipërcituar			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Stafi akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Bazuar në deklaratimet e studentëve dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, ata shprehën pozitivisht për ndihmën dhe mbështetjen e stafit akademik në sigurimin e teksteve, leksione apo literature ndihmëse që ju nevojitet gjatë vitit akademik. Komunikimi midis stafin akademik studentë realizohet nëpërmjet e-mail, platformës www.unireald.edu.al i cili siguron komunikim interaktiv midis studentëve dhe pedagogëve apo platforma on line Goole classroom, për të cilën janë hartuar dhe udhësuesit përkatës. [takimi me studentet, dokumenti 45. Google Classroom Manuali student.pdf; dokumeti 46. Manual për programin OBS për regjistrim Video dhe audio.pdf; dok 47. Google Classroom Manual pedagogu.pdf.]			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.				
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Institucioni ka krijuar infrastrukturën për monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrative apo raportimin e brendshëm që realizohet nëpërmjet komunikimit me emailin e brendshëm zyrtar emer.mbiemer@unireald.edu.al . [me stafin drejtues dhe studentë, pedagogë]			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni disponon faqen e tij të internetit [www.unireald.edu.al] e cila përmban informacione të vlefshme për informimin e publikut. Faqja e internetit ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Informacionet në lidhje me programet e studimit, përmbajtjen, strukturën/organigramën përditësohen dhe publikohen në faqen e universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Menaxhimi financiar i Institucionit është i lidhur me aktivitetin e bizneseve, pjesë e shoqërisë themeluese. Financat e institucionit administrohen nga Bordi i Administrimit. Referuar Statutit të KUR [statuti KUR], institucioni çdo vit harton buxhetin bazuar në propozimet e njësive dhe strukturave të kolegjit. <i>GVJ-së iu vunë në dispozicion të dhëna mbi aktivitetin financiar, realizimin e tij në nivel institucional, por në këto dokumenta [raporti financiar vjetor] nuk jepen të dhëna financiare të detajuara në lidhje me aktivitetin e shoqërisë, shpenzime operative dhe informacioni është përmbledhur në formën e një raportimi analitik në funksion të realizimit të aktivitetit akademik për institucionin [takim me ZBNJ & ZF],</i></p>			
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Institucioni kryen audite financiare në zbatim të kuadrit ligjor financiar në fuqi në RSH. KUR është një institucion jopublik i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentet shoqëruese deklarohet se burime të financimit janë tarifatat e studentëve (regjistrimit dhe shkollimit), të ardhurat nga projektet me IAL të tjera investime nga veprimtaria e biznesit të shoqërisë themeluese/kompania mëmë. <i>Në raportin financiar të paraqitur mungon një pasqyrë të hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Referuar raportit financiar mbi kostot e programit të studimit GVJ konstatoi se institucioni ndjek politikën e dhënies së bursave në nivelin 100% për studentët me note mestare 10, dhe 50% për kategoritë në nevojë dhe studentët me aftësi ndryshe, dhe për studente me mesatare note 9.6. [raporti për koston vjetore të programit të studimit, financimi].</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Përdorimi i fondeve ka shkuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, investimit në laboratorë dhe auditorë, shtimit të titujve në bibliotekë, proceseve të informatizimit, punësimit të stafit akademik të kualifikuar, financimit të veprimtarive shkencore, por nuk ka informacion të detajuar për shpërndarjen e fondeve sipas zërave të caktuar. Gjatë vizitës në institucion në takim me drejtuesit dhe administratorin e KUR u deklarua se institucioni është me fitim, dhe investimet i bazojnë në studimin e tregut të punës, kërkesat në rritje për infermierë për shkak të largimit të stafit infermieror në emigracion, duke përmbushur dhe misionin e KUR për të shërbyer vendit në plotësimin e nevojave për personel infermieror..</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUR është institucion jo publik i cili bazon aktivitetin e tij në bazën ligjore aktuale në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore (statuti KUR, rregulloret) për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e kolegjit të miratura me vendim të senatit akademik. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në rregullore, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Pranë FSHM funksionon zyra e këshillimit të studentëve. Në rregulloret e FSHM dhe rregulloren e programit të përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen ëeb të universitetit. [dok 3. Statuti i KUR; dok 66. rregullore e sekretarisë, dok 63.rregullore provimit, dok 83.rregullore zyrës së këshillimit të karrierës].
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	FSHM ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. Studentët deklarojnë se institucioni zhvillon procedura transparente duke siguruar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. [takimi me studentët, dok 7. Regullorjar FSHM,].
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Pranimi i kandidatëve për të ndjekur studimet bachelor në Teknik laboratorin në mjekësi, bëhet në bazë të kriterëve të miratuar nga senati akademik. Në fazat e regjistrimit, institucioni publikon kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve të cialt janë të aksesueshme nga publiku në faqen online të KUR [faqja e internetit KUR]. Studentë duhet të zotërojnë një diplomë e shkollës së mesme Matura shtetërore, të lëshuar nga MASR ose një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë shtetit por të vlerësuar ekuivalente me atë të shkollës së mesme. Procedura e aplikimit, konkurimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve të cilët aplikojnë për programin e ciklit të parë të studimit
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	

Bachelor në “Teknikë Laboratori në Mjekësi”, kryhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. **[rregullore e programit].**

Në kreun 5 të rregullores së përgjithshme të IAL janë shkruar qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për:

- Organizimin e programeve të studimit
- Kriteret për pranimet në ciklin e parë dhe të dytë
- Procedurat e miratimit të kuotave dhe tarifave
- Ndërprerjen e studimeve, procedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programi të dytë studimi
- Rregullat e ekuivalentimit etj.

Rregullorja e përgjithshme IAL, FSHM, Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome.

Pranë FSHM funksionon zyra e këshillimit të karrierës e cila së bashku me grupin e tutoriatit kontaktojnë dhe asistojnë studentë e rinj që në regjistrim, ndjek dhe mbështet ecurinë akademike dhe profesionale të studentëve, mundësor: çdo informacion dhe oportunitet të ofruar nga institucionet partnerë si për studentët ashtu dhe për kandidatët për student pranë institucionit tonë akademik. Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i publikuar dhe në faqen web të KUR. Në takim me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e zyrës së këshilltarit akademik, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre. **[dok 7 Rregulloret eFSHM, dok 6. rregullorja përgjithshme IAL dhe dok 8 programit të studimit, këshillimit të karrierës, takimi me studentët]**

Përgjatë vitit akademik, institucioni ndjek ecurinë e studentëve në programin e studimit **[të dhëna për notat e studentëve hyrje-dalje].** Procedura e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme është e mundur, në programin e studimit ka patur raste të transferimit të studimit nga IAL të tjera në KUR apo program të dytë. **[dok 86 të dhëna mbi regjistrimin e studentëve]**

GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar në rregulloret e Përgjithshme të IAL, FSHM dhe të programit të studimit kriteret e përgjithshme dhe të vecanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo student që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM. Kriteret e miratuar i dergohen MASR përfara fillimit të vitit akademik. **[dokumenti 7 & 8 Rregullorja e FSHM dhe programit të studimit]** Hartimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike për pranimin në programet e ciklit të parë të studimit mbështetet në aktet ligjore të MASR. Institucioni ka

	parashikuar dhe kuota për regjistrimin e studentëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara.			
	Pas kërkesës së MASR, cdo vit FSHM përcakton kriteret dhe kuotat e pranimit të cilat aprovohen nga Senati akademik. Senati akademik i dërgon kuotat dhe kriteret e pranimit në MASR. Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në portalin e universitetit [dokumenti 7 & 8 Regullorja e FSHM dhe programit të studimit]. KUR dhe FSHMT kanë në traditën e tyre organizimin e materilave informuese dhe postera për prindër dhe gjimnazistë të interesuar për programet e studimit që ofron, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen ëeb të KUR.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e FSHMT, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregulloret është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit:
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	- Leksione 75% - Seminare 75%: Kur studenti ka marrë pjesë në 50 – 75 % nuk ka të drejtë të futet në provimin e radhës por kalon në sezonin e vjeshtës. Kur studenti ka marrë pjesë në më pak se 50% të tyre, ai përsërit lëndën në vitin e ardhshëm
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	- Frekuentimi i punëve laboratorike, detyrave të kursit, mësimit praktik: Është i detyrueshëm në masën 100 %. Kur studenti nuk ka frekuentuar deri në 25 % të punëve laboratorike të çdo lënde, i shlyen ato në dy javët e fundit të vitit në vazhdim, apo semestrit kur lënda është semestrale. Nëse ka frekuentuar më pak se 75 % të tyre, i shlyen ato në vitin pasardhës
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	- Të dhënat për frekuentimin janë të pasqyruara dhe në syllabusin e secilës lëndë.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<i>GVJ konstaton se ka një mospërputhje të shkrimit për masën e frekuentimit për leksionet dhe seminarat në rregulloren e përgjithshme të IAI, FSHMT- syllabuset. GVJ rekomandon</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

korrigjimin eventual të shifrave në rregulloren e programit të studimit.

Në rregulloren e FSHMT, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Në këtë rregullore ka nene specifike për procedurat e transferimit apo të ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësitë e ndjekjes së programeve të dyta të studimeve. **[rregulloret e FSHMT]** Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllbus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar.

Vlerësimi i vazhduar ka dy komponentë:

- Vlerësimin e vazhduar 40% të notës përfundimtare.
- Aktivizimi 10%
- Provim I ndermjetëm 30%
- Provimi përfundimtar zë 60% të notës përfundimtare.

Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit. Ata përdorin dhe procedurat e rishikimit të vlerësimit. **[rregullorja e FSHMT dhe programi studimit dhe syllabuset]**

Në rregulloren e FSHM dhe rregulloren e diplomimit janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit **[dokumenti 81]**.

Në rregullore përcaktohet:

- Diplomimi bëhet me provim përfundimtar ose temë diplome
 1. Për provimin përfundimtar të formimit rregullorja përcakton procedurën e informimit të studentëve për temat e provimit, procedurën e hartimit të tezës, elementët e tezës, procedurën e vlerësimit, ankimit dhe rivlerësimit.
 2. Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës.
- Kushtet që duhet të përmbushë student për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit.

Udhëzuesi për punimin e temes së diplomes **[dokumenti 38]**

GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës). Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve dhe posterave, informacionit në mediat lokale, top Albania radio, takime të stafit akademik me maturantët në gjimnaze. Informacioni ju vihet në dispozicion për gjimnazistët dhe prindërit e interesuar. Informacioni përditësohet dhe në faqen eeb të KUR **[evidencat 96 dhe faqja Web]**

Shkalla e përmbushjes së standardit

Nuk përmbushet

Përmbushet pjesërisht

Përmbushet kryesisht

Përmbushet plotësisht

X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët që ndjekin programet mësimore Bcs në Teknik laboratorit nënjekësi informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Në dosjen e programit të studimit ata gjejnë:
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<ul style="list-style-type: none"> - Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit - Informacion për objektivat formuese të programit - Strukturën dhe organizimin e programit - Planin mësimor - Syllabuset - Rregulloren - Suplementin e diplomës
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studentit gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studentit orientohet për tematikën dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimi (leksion, seminar, praktikë). Studentët e vitit të parë informohen dhe orientohen që në fillim nga zyra e këshillimit të karrierës dhe grupi i tutoriatit që ai krijon me studentët të viteve të fundit. [syllabuset e lëndëve, programi mësimor, orari mësimor]
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve për mundësitë e punësimit. Institucioni ka lidhje të ngushta me operatorët mjekësorë dhe me Urdhërin e Infermierit, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Institucioni merr informacion dhe nga portali Infermierë për Shqipërinë. Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe gjithë informacionin që merr nga agjensi të huaja punësimi, megjithëse i mungojnë statistikat e sakta. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete trajnuese brenda qytetit dhe me gjerë në rajon, shton mundësitë e informimit dhe promovimit të studentëve në tregun e punës [takimi me stafin drejtues dhe akademik, grupin e vlerësuesve të brendshëm]
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Në dosjen e programit të studimit studentit informohet dhe me infrastrukturën e programit të studimit. <i>Pika e dobët e infrastrukturës së programit është mungesa e laboratorit mjekësor</i>

	<p><i>biokimik klinik, mikrobiologjik për aftësimin praktik të studentëve.</i></p> <p>Numri i klasave është optimal dhe nga vizita në universitet konstatohet që janë OK. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitalet rajonale.</p> <p>Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë. [dosja e programit të studimit, vizita në universitet, marrëveshjet e bashkëpunimit] Në RVB theksohet se KUR ka një sistem informatic të brendshëm përmes të cilit mundësohet informimi studentit për programin e studimit. Vec detajeve për programin e studimit dhe detajeve individuale për notat etj. Platforma sivjet i ka shërbyer mesimit on line. [faqja web e programit të studimit]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.	Në sekretarinë mësimore të FSHMT janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. Sekretaria ka <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar të studentëve - Regjistrin e lëshimit të diplomave - Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit. [takimi me sekretarinë mësimore]
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të cregjistrimit. [dokumenti 86,87]
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me	GVJ konstaton se institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit nga pranimi deri në diplomim. Në sekretarinë mësimore të dhënat arkivohen në regjistrin e notave si dhe në formë procesverbalesh. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u njoh modelet e regjistrave të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>lëndëve dhe regjistrave të praktikës. [vizita në sekretarinë mësimore]</p> <p>Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, KUR ka përpiluar rregulloren e FSHM dhe rregulloren e përgjithshme të IAL për regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumentave në KUR. Këto rregullore [dokumenti 6.7] është miratuar me vendim të senatit akademik. Dokumentacioni ruhet në sekretarinë mësimore; prej tij përpilohen dokumentat që iu dorëzohen studentëve. GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit, regjistrat. [vizita në sekretarinë mësimore]</p> <p>Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore (evidencat e analizave gjenden në dokumentacion). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Një kopje e këtij raporti i dërgohet dhe MARS. [dokumenti 59 Raporti vketor I IAL]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të KUR. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin e KUR, në Njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB. Studentët organizojnë Këshillin studentor. [dok 3. statuti i KUR, dok nr6 rregulloret e FSHMT]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSHMT. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik. [pyetorët, takimi</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e</p>	<p>[pyetorët, takimi</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	me studentët]			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Plani mësimor i programit të studimit është ndërtuar mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi duke respektuar të gjitha kriteret për ngarkesën në auditor dhe jashtë tij si dhe për shpërndarjen e ngarkesës në orë teorike dhe praktike. Në rregulloren e FSHMT dhe rregulloren e programit të studimit parashikohen qartë procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të elementëve të studimit. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies edhe në kushtet aktuale të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve online. Studentët gjykojnë se praktikat profesionale në spitalet rajonale dhe laboratorët mjekësor jo public i pregatisin mjaft mirë për aftësimin e tyre profesional dhe për tregun e punës, <i>por theksojnë mungesën e laboratorëve mësimorë mjekësor në shkollë.</i> Raportin teori-praktikë e vlerësojnë shumë të mirë. [plani mësimor, rregullorja e programit të studimit, takimi me studentët]			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHMT për zgjidhje. Këshilltari karrieres është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Pyetsorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre. Në takim me stafin akademik u theksua se <i>ky është një program i ri studimi nuk ka patur sygjerime nga studentët për përmirësime. Ndërsa në takimin me studentët ata u shprehën mungesën e laboratorit mjekësor të biokimisë dhe mikrobiologjisë, por këtë mungesë e kanë plotësuar duke realizuar praktikën lëndore në laboratorët që kanë marrveshje bashkëpunimi institucioni.</i> [takimi në institucion] Në rregulloren e FSHMT dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit [rregullorja e përgjithshme e IAL, neni 58] . Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve (provime me shkrim) dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Ata theksuan se nuk ka patur raste të rishikimit të provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.6

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>FSHMT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e këshillimit të karrierës që organizon dhe sistemin e tutoratit për studentët e sapo regjistruar. Kjo zyrë asiston studentët nga momenti i regjistrimit deri tek këshillimi për mundësinë e ndjekjes së programeve të tjera të studimit (master) apo për mundësitë e punësimit. Grupi i tutoratit krijohet nga student të viteve të larta dhe asiston studentët e vitit të parë në adaptimin me sistemin e mësimdhënies dhe akomodimin.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. - Zyra e studentit: informon studentët për sistemin e bursave, sistemin e akomodimit (konviktet) - Koordinator i praktikave: koordinon studentët për praktikat në spitalet rajonale. [rregulloret e FSHMT, takimi në institucion]
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. [takimi në institucion]
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përka. ëse.</p>	<p>Në institucion funksionon zyra e këshillimit të karrierës, Alumni. Kjo zyrë është riorganizuar për të ofruar shërbim më të mirë në kuadër të strukturimit të programeve dhe ofrimit të programeve të reja. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë - Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune - Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës - Identifikimin e aftësive dhe shprehive <p>Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj.</p> <p>Në fillim të vitit zyra parashikon aktivitetet dhe përcakton buxhetin për aktivitetet e këshillit studentor i cili miratohet me vendim të bordit të administrimit. [dokumenti 64. vendim I bordimit të administrimit për këshillin studentor]</p> <p>Në takimin e GVJme zyrën e këshillimit të karrierës u informuam se kjo njësi është riorganizuar së fundmi dhe ka në database informacion për studentët e diplomuar. Njësia e këshillimit të karrierës mban lidhje</p>

	me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit. Për këtë program studimi nuk ka të dhëna për punësimin e tyre pasi ky është viti i parë i të diplomuarve në këtë program studimi. Situata e pandemisë ka vonuar krijimin e database të plotë. [dokumenti 87 te dhëna për punësimin e studentëve në vitët 2016-2019]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	KUR ka përpunuar, zbaton politika dhe ka ndërtuar struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: "Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë". Struktura dhe funksionimi i Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionit të Arsimit të Lartë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësitë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, të programeve të studimit, aspekteve të mësimdhënies etj.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. IAL Bazuar në Statusin dhe Rregulloren e "Sigurimit të brendshëm të cilësisë" me vendim të Senatit Akademik është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Zyra ka rregulloren mbi të cilën bazon aktivitetin e saj [rregullore NJSBC] duke ndëkur politika në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore. Në përbërje të NJSBC janë pesë anëtarë ku 3 persona janë personel akademik të njësive kryesore, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga këshilli studentor. <i>GVJ pas shqyrtimit të rregullores rekomandon përditësimin dhe rishikimin e rregullores së NJSBC, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë.</i> Në detyrat e NJSBC përfshihet vlerësimi i rezultateve të veprimtarive
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>mesimore, kërkimore shkencore duke propozuar dhe ndryshime të nevojshme në funksion përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. [Rrgullore NJSBC ,takim me përfaqesues të zyrës.]</p> <p>Në objektivat strategjike të zhvillimit të institucionit [strategjia 21-26], janë parashikuar veprimtaritë: 1. për zhvillimin institucional, për përmirësimin e programeve dhe stafin akademik, partneriteti me të huaj, implementimi i programeve të studimit dhe kërkimi shkencor. Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaroi se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të KUR dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm.</p> <p>NJSBC përpiket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë të cilat kanë nevojë të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë (Standardi VI.1).</p> <p><i>GJV eidenton se vlerësimet e kryera për mësimdhënien (referuar pyetësorëve për studentin dhe vlerësimin e pedagogëve) [87, 88], janë vetëm përshkruese jo analitike , kështu rezultoi se pyetjet janë standarte pa përmbushje të qëllimit final të pyetësorit. Edhe raporti i përgatitur nga NJSBC [90, raporti vjetor njsbc], është jo i plotë bazuar në fushën e veprimtarisë që NJSBC ka. Gjithashtu proceset që kryhen gjatë vitit akademik të parashikuara në planin vjetor të punës, më tepër janë aktivitete të institucionit dhe jo një politike e qartë me mekanizma dhe aktivitete për sigurimin e cilësisë. Ne konstatojmë se njësia vepron kryesisht me veprimtari had-hoc.</i></p> <p>Në këtë drejtim KUR duhet të ndjekë politika të qarta të cilat realizohen nëpërmjet procedurave periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të NJSBC-së [plani i punës NJSBC]. <i>Theksojmë se në këto procese duhet të krijuar një kulturë bashkëpunimi në rang institucional , duke përfshirë të gjitha aktorët .</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të</p>

të studimit të ciklit të parë.	ciklit të parë të studimeve, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të KUR-it në përputhje me standardet si dhe të monitoroj punësimin e studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga IAL. Njësia përgjegjëse për kryerjen e këtij funksioni është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zyrës së karrierës.		
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<i>Në përmbushjen e këtyre qëllimeve një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSHM ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL.</i>		
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj. Procesi i monitorimit dhe shqyrtimit të programit të studimit kryhet kryesisht mbi bazën e veprimtarive të përgjithshme dhe jo në funksion të cilësisë. <i>GVJ nuk ka evidentuar procese konkrete të dokumentuara të rishikimit më qëllim përmirësimin në këtë program studimi</i>		
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC [raporti vjetor 2019], [raporti NJSBC]. Megjithatë, <i>GVJ evidenton se raportimet vjetore janë kryesisht informative dhe jo në kontekstin e përmirësimin të cilësisë apo treguesëve të veçantë të saj.</i> Për këtë arsye, njësia duhet të marrë rol kryesor jo vetëm në hartimin e planit të punës apo zhvillimin e pyetësorëve standartë por përfshijë edhe metoda të tërthorta vlerësimi dhe verifikimi, të cilat sigurojnë që rezultatet e sondazheve i përafrohen realitetit në të cilin ndodhet institucioni. [pyetësori i studentëve]		
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Në takimin me anëtarët e NJSBC, u deklarua se për shkak të situatës nga pandemia Covid-19, zyra e ka patur të vështirë të koordinojë veprimtaritë e veta në nivel institucional me strukturat e tjera të kolegjit. NJSBC është duke plotësuar dhe konsoliduar veprimtarinë e vet duke u bazuar në rekomandime dhe plane pune që adreson përmirësimin e problematikave të evidentuara. <i>GVJ rekomandon rritje e efikasitetit në analizimin e informacionit dhe të dhënave, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave. [Dokument nr. 53 Formular NJSBC - Vlerësim i studentit për pedagogun 2019-2020.pdf.pdf; Dokument Nr.54. Formular për Studentet - për vitin akademik 2019-2020.pdf.pdf]</i>		
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Bazuar në dokumentet e KUR dhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në IAL rezultoi se NJSBC bën vlerësim institucional dhe harton raporte periodike për të gjithë programet e studimit. <i>GVJ thekson se analiza vjetore e programit e përfshirë në raportin e përgjithshëm ka të dhëna sasiore por nuk bën analizë apo adresim të problematikave.</i></p> <p>Sikundër përmendëm më lart, NJSBC duhet të verë në zbatim mekanizma gjithëpërfshirës dhe ti përdorë informacionet e mbledhura për vetëvlerësime periodike të performancës dhe ecurisë aftatgjatë të institucionit (Standardi VI.3). Metodot dhe instrumente të ndryshme për monitorimin dhe vlerësimin si monitorimi i mësimdhënies, realizimi i provimeve, anketimeve etj., u deklarua se zhvillohen në mënyrë periodike [takimi me drejtuesit]. Edhe në planin vjetor të punës janë parashikuar aktivitete [plani i punës NJSBC]. Metodot për vlerësim të cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të anës pedagogjike të mësimdhënies dhe përbajtjes së programit dhe përputhshmërinë e tij me nevojat e studentëve, zhvillimin e metodave të të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, nuk u raportuan dhe nuk u evidentuan që kryhen.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një numer mareveshje bashkëpunimesh me institucionet shëndetësore kombëtare dhe institucione arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare. [marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare] Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë në nivelin akademik realizohet kryesisht me Universitetin e Vlorës. <i>GVJ rekomandon vënien në efikasitet të plotë e këtyre marrëveshjeve në funksion të ritjes nga ana cilësore të nivelit të personelit akademik dhe plotësimin e mangësive të konstatuara.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Përfshirja e aktorëve të jashtëm jep një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale, si dhe në studimin e tregut të punës. Përfshirja e këtyre aktorëve nëpërmjet diskutimeve për zhvillimin e programit nuk u evidentua edhe pse drejtuesit theksuan se këto takime realizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ. Po ashtu, edhe bashkëpunimi me punëdhënësit dhe partnerët që përfshihen në</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	

	<p>realizimin e programit nuk kanë dhënë kontribut në kuadër të përmirësimit të programit të studimit [raporti analitik i marrëveshjeve]. Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, institucioni <i>përdor metoda të pakta vlerësimi kryesisht pyetësorë për studentët dhe jo për personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë, palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të programit.</i></p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës mbështet studentë gjatë viteve të studimit, siguron informacion nga partnerët, organizon takime me Alumni, këto takime janë shumë të vlefshme për të tërhequr mendimet e studenteve të diplomuar, sa ka ndikur arsimit i marrë në IAL për karrierën e tyre, gjërat që mund të përmirësohen me qëllim rritje e kompetencave profesionale për të përballuar sa më mirë tregun e sfidat e profesionit.</p> <p>GVJ thekson që aktorët e jashtëm japin një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale por <i>mungon kontributi i tyre konkret në vlerësimin e realizimit dhe cilësisë së programit të studimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij.</i></p> <p><i>Për sa më sipër GVJ rekomandon që NJSBC të fokusohet në krijimin dhe zbatimin mekanizmave dhe instrumente të tërthorta për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program studimi me përfshirje të gjith aktorëve.</i></p>			
Shkalla e përmirësimit të standardit	Përmirësohet	Përmirësohet pjesërisht	Përmirësohet kryesisht	Përmirësohet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka eksperiencë në disa procese akreditimi gjatë këtyre viteve të funksionimit të tij. Nëpërmjet akteve ligjore rregullatore të tij si statusi, rregullore garanton përfshirjen e studentëve dhe personelit akademik si aktor të brendshëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Duke u bazuar në ligjislacionin në fuqi, Rregulloren e NJSBC, Institucioni ka përcaktuar detyra konkrete dhe kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, kriteret për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, rishikimin periodik të programit të studimit, me qëllim garantimin e cilësisë së tij.</p> <p>Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	

<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>administrativ dhe studentët e programit të studimit, është garantuar nga statuti i institucionit dhe rregullorja e NJCBC. Njësia bazë ka marrë rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit [riorganizimi i programit]. <i>Por GVJ konstatoi se përfshirja e studentëve në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit nuk rezultoi në nivelin e duhur pasi vetë studentët nuk janë të informuar mbi ndryshimet e fundit të kryera në vitin 2020 [takimi me studentët]</i>. GVJ vlerëson pozitivisht përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në studimin e tregut të punës.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>I gjithë ky proces përpiket të shmange çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve, duke respektuar integritetin akademik dhe shmangjen e diskriminimit apo pabarazisë. KUR ka eksperiencë pozitive në angazhimin e personave të kualifikuar dhe profesionistëve si pjesë e personelit akademik me kontratë. Në këtë drejtim kontributi i tyre është i dukshëm në ofrimin e programit. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është kryesisht had-hoc por evidentohen përpjekje të cilat mund të jenë pikënisje në të ardhmen për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me strukturat e institucionit në mënyrë që veprimtaritë e sigurimit të cilësisë mos shihen si detyrë vetëm e NJSBC por si proces në të cilin integrohen dhe përfshihen të gjithë aktorët e institucionit.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p><i>GVJ mendon që angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij duhet të rrëtohet dhe të ketë efekte konkrete në përmirësimin e tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Institucioni ka të publikuar në faqen zyrtare të tij informacione që informojnë publikun dhe studentët e rinj. Dokumentet kryesore janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit. Ndërkohë informacionet në lidhje me veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për institucionin në tërësi dhe për programin e studimit në veçanti janë të pakta. [faqja e internetit KUR].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin</p>	<p>Një pjesë e informacioneve që lidhen me sigurimin e cilësisë janë kryesisht informuese ndërsa sikundër është deklaruar në takime me</p>

për të dhënat personale.	<p>stafin akademik, institucioni është i hapur për këdo për të dhënë informacione të detajuara në institucion në versionin e printuar apo elektronik. GVJ nuk evidentoi raste të thyerjes së lirisë akademike apo shkelje të legjislacionit për të dhënat personale [vizitë zyra e burimeve njerëzore]. <i>GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike.</i> Këto raporte nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p>Prandaj <i>GVJ rithekson që në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni duhet të zhvillojnë më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm</i></p> <p>Gjatë takimit me NJSBC, [takimi NJSBC] u deklarua se IAL organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Megjithatë, për shkak të pandemisë Covid 19, këto veprimtari <i>kanë qënë të limituara.</i> GVJ nuk identifikoi veprimtari dhe informacione që lidhen me veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Për sa më sipër GVJ rekomandon shtimin dhe rritjen e efikasitetit të aktiviteteve me personelin dhe studentët, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.				
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelorë në “Teknik laborator i në mjekësi”, të Institucionit të arsimit të lartë, Kolegji Universitar “REALD”.

Pika të forta dhe afirmimet:

1. Kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Teknik laborator i në Mjekësi” është hartuar bazuar në modelet kombëtare dhe evropiane, duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.
2. Institucioni disponon kapacitetet infrastrukture dhe logjistike të mjaftueshme në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies.
3. KUR ofron mundësi të mira për studentët për realizimin e praktikave profesionale në qendrat spitalore dhe shëndetësore në rajonin e Vlorës e më gjerë.
4. Institucioni ka partneritet dhe bashkëpunime me disa institucione, të cilat, nëse vihen në zbatim sikundër është parashikuar në marrëveshjet e bashkëpunimit, do të ndihmojnë në ecurinë e mëtejshme të institucionit.

Pika të dobta:

1. Mungesa e infrastrukturës mjekësore/laboratorët mjekësorë dhe stafit akademik mbështetës/ laborant për realizimin e praktikës lëndore dhe në funksion të programeve të studimit që ofron.
2. Njësia përgjegjëse për programin e studimit **nuk përmbush plotësisht standartet që lidhen me formimin profesional të personelin akademik.** Evidentohen problematika përse i përket kapaciteteve akademike si:
 - a) Paqëndrueshmëri e stafit akademik
 - b) Mungesa të theksuara të pedagogëve me formin e duhur profesional apo specialitetin përkatës sidomos në lëndët karakterizuese të programit
 - c) Një pjesë e pedagogëve zhvillojnë më shumë se tre lëndë dhe kanë ngarkesë të lartë mësimor .
 - d) Mungesë e titullarëve të lëndës nga pedagogë të kategorisë profesor.
3. Institucioni nuk ka përmbushur kërkesat e Ligjit të Arsimit të lartë , sipas të cilit të gjithë Lektorët duhet të jene të paktën me gradën Doktor i Shkencave. Vetëm një pjesë e vogël e moduleve kanë titullarin të kategorisë Profesor.
4. Institucioni nuk disponon/aplikon sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit i cili të mundësojë një sërë shërbimesh dhe funksionesh për administrimin dhe menaxhimin e proceseve dhe aktiviteteve të ndryshme.
5. Për programin e studimit, mungojnë analiza dhe raporte periodike financiare ku të paraqiten të dhëna mbi kostot e programit të studimit, një pasqyrë të hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare si dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një vit akademik.
6. NJSBC dokumenton në mënyrë të pjesshme të dhënat që lidhen me sigurimin e cilësisë. Analizat, raportimet dhe propozimet/rekomandimet për adresimin në të ardhmen të problematikave nuk janë pjesë e raportimeve periodike. Nuk ka përfundime që të shoqërohen me plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

7. Programi nuk ka një rregullore/udhezues të shkruar mbi organizmin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën

Rekomandime:

GVJ rekomandon si më poshtë:

1. Sigurimi i infrastrukturës mjekësore/laboratorët mjekësorë dhe stafit akademik mbështetës/ laborant për realizimin e praktikës lëndore dhe në funksion të programeve të studimit që ofron.
2. Institucioni, duhet të rrisë cilësinë e personelit me kohë të plotë në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe të standardeve të cilësisë. Institucioni, të rekrutojë personel me kualifikimin, fushën akademike-kërkimore në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të programit dhe të motivojë/promovojë ata në mënyrë që të garantojë cilësi dhe qëndrueshmëri afatgjatë të tyre në institucion.
3. Rishikimin e shpërndarjes së lëndëve pedagogëve sipas formimit të tyre profesional dhe grupimi sipas tipologjive të ngjashme dhe angazhimin e lektoreve me grade shkencore.
4. Riorganizimin dhe përditësimin e programit të studimit si ndarjen simestrale të lëndëve të programit, shpërndarjen e ngarkesës si në orë ashtu dhe në disiplina sipas pedagogeve.
5. Institucioni, të verë në zbatim marrëveshjet e nënshkruara me partnerët e huaj për të rritur mobilitetin e stafit dhe studentëve të programit të studimit në funksion të rritjes nga ana cilësore të nivelit të personelit akademik dhe plotësimin e mangësive të konstatuara.
6. Institucioni, të kategorizojë kontratat punës në përputhje me Udhëzimet e MASR, Kodin e Punës, aktet rregullatore të KUR si dhe përcaktimet ligjore të ligjit të arsimit të lartë në lidhje me kategoritë e personelit akademik në IAL. Në kontratën individuale të punës të përcaktohet departament apo programi ku është punësuar pedagogu si dhe ngarkesa mësimore që ai realizon në vitin akademik.
7. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses në bibliotekat on-line të fushës së mjekësisë të cilës i përket dhe programi i studimit.
8. Institucioni, të konsolidojë funksionimin e NJSBC, e cila duhet të fokusohet në mbledhjen e të dhënave, informacioneve, hartimin e dokumenteve dhe analizave e të kontribuojë në realizimin e proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që vlerësojnë performancën dhe promovojnë e përmirësojnë cilësinë në institucion.
9. Përditësimin dhe rishikimin e rregullores së NJSBC, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë.
10. Dokumentimin dhe miratimin e detyrave, përgjegjësive dhe mënyrën e raportimit të koordinatorit për programin e studimit.
11. Hartimin dhe miratimin e rregullores/udhezuesi të shkruar mbi organizmin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën.
12. Rishikimin e rregulloren e përgjithsme të IAL FSHMT, rregullores së programit të studimit, dhe syllabuset lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe seminarve nga studentët. Rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe të literaturës së syllabuseve. Titullarët e lëndëve duhet të jenë të kategorisë profesor.


Conclusions of the evaluation of the first cycle study program Bachelor "Laboratory technician in Medicine" of University College "REALD".

Strengths and affirmations:

1. The curriculum of the study program of the first cycle Bachelor "Laboratory technician in Medicine" is designed based on national and European models, respecting the standards and legal framework in force.
2. The institution has sufficient infrastructural and logistical capacities in function of the study program for the realization of the teaching process.
3. UCR offers good opportunities for students to pursue professional internships in hospital and health centers in the Vlora region and beyond.
4. The institution has partnerships and collaborations with several institutions which, if implemented as provided in the cooperation agreements, will help the institution progress.

Weaknesses:


1. Lack of medical infrastructure / medical laboratories and academic support staff / laboratory technicians for the realization of the course practice and in function of the study programs it offers.
2. The unit responsible for the study program does not fully meet the standards related to the professional training of academic staff. Problems are identified in terms of academic capacity such as:
 - a) Instability of academic staff.
 - b) Significant lack of academic staff with the appropriate professional training, especially in the characterizing modul/subjects of the program.
 - c) Part of academic staff develop more than three subjects and have a high teaching load .
 - d) Lack of course holders from the academic staff of the professor category (Standards II.2).
3. The institution has not met the requirements of the Law on Higher Education, according to which all Lecturers must be at least with the degree of Doctor of Science. Only a small part of the modules have the course holders from Professor Category.
4. The institution does not have/applies an internal data and information management system which provides a range of services and functions for the administration and management of various processes and activities.
5. For the study program, there is a lack of periodic financial analysis and reports presenting data on study program costs, a detailed financial statement of income from tuition fees and other financial contributions for students or the allocation of financial resources, the plan of financial support, necessary for the progress of the study program for at least one academic year.
6. The IQAU partially documents the quality assurance data. Analyzes, reporting, and suggestions/recommendations for addressing issues in the future, are not part of periodic reporting. There are no conclusions to be accompanied with action plans that address and aim to address the improvement of the identified shortcomings and weaknesses.
7. The program does not have a written regulation / guide on the organization of professional practice and the evaluation of students for the internship.



Recomandation:


EEG recommends as follow:

1. Establishment of medical infrastructure / medical laboratories and academic support staff / laboratory technician for the implementation of course practice and in function of the study programs it offers.
2. Institution should increase the quality of full-time staff in compliance with legal obligations and quality standards. The Institution should recruit staff with the qualification, academic-research area in accordance with the nature and specificity of the program modules and motivate/promote them in order to guarantee their long-term quality and sustainability in the institution.
3. Reviewing the distribution of moduls/subjects of study program to academic staff according to their professional qualification and grouping them according to similar typologies. Engagement of lecturers in this study program with scientific degrees.
4. Reorganization and updating of the study program such as define the modules program according to semester, the distribution of the workload both in hours and modules for each academic staff.
5. Institution, should implement the agreements signed with foreign partners to increase the mobility of study program staff and students) in order to qualitatively increase the level of academic staff and fill in the gaps identified.
6. Institution, should categorize employment contracts in accordance with MASR Bylaws, Labor Code, UCR regulatory acts and legal provisions of higher education law related to categories of academic staff in HEIs. To determine in the individual employment contract the department or study program where the academic staff is employed as well as the workload/hours that he realizes during academic year.
7. The institution should create opportunities for access to on-line libraries related to the medicine field of the study program.
8. Institution should consolidate the functioning of the IQAU, which should focus on collecting data, information, drafting documents and analysis, and contribute in the implementation of external accreditation processes, analytical and benchmarking evaluations, and other processes that evaluate performance and promote and improve quality in the institution.
9. Updating and revising the regulation of the IQAU, in order to more clearly define the areas of activity.
10. Documentation and approval of tasks, responsibilities and the way of reporting of the the study program coordinator.
11. Drafting and approval of the written regulation/guide on the organization of professional practice and the evaluation of students for it.
12. Review of the general regulation of HEI, FMST, the regulation of the study program, and syllabus related to the attendance of lectures and seminars by students. Review syllabus literature and course holders. The course holders should be the academic staff of the professor category.




Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	



I. LISTA E EVIDENCAVE MBËSHTETËSE

1. Urdher i rektorit per GVB.pdf
2. Mendimi i dekanit të Fakultetit.pdf
3. Statuti i Kolegjit Universitar REALD.pdf
4. Strategji zhvillimi 2016 - 2021.pdf
5. Akti i miratimit te Strategjise se Zhvillimit 2016-2021.pdf
6. Rregullore e pergjithshme e IAL..pdf
7. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.pdf
8. Rregullore e programit bachelor ne Teknik Laboratori ne Mjekesi.pdf
9. Program Bachelor në Teknik Laboratori në Mjekësi..pdf
10. Strategji Zhvillimi 2021-2026.pdf
11. Vendim i Bordit per miratimin e Strategjise se Zhvillimit 2021-2026.pdf
12. Studim Tregu ne fushen e shendetesise.pdf
13. Plani mesimor Bachelor ne Teknik Laboratori në Mjekësi. 2018-2021.pdf
14. Te dhena per personelin per vitn akademik 2018 - 2019.pdf
15. Te dhena per personelin akademik - per vitin akademik 2019 - 2020.pdf
16. Lista e stafit akademik 2020 - 2021.pdf
17. Organigrama e Kolegjit Universitar REALD.pdf
18. Urdher per emerimin e koordinatorit te programit TLM.pdf
19. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të IAL..pdf
20. Marreveshje bashkepunimi me Universitetin e Mjekesise Tirane.pdf
21. Marreveshje bashkepunimi me Universitetin e Vlores I.Qemali.pdf
22. Marreveshja e bashkepunimit me Universitetin e Fogias.pdf
23. Marreveshje bashkepunimi me Universitetin e Salernos - Itali..pdf
24. Marreveshje bashkepunimi me Spitalin Rajonal Vlore.pdf
25. Marreveshje bashkepunimi me Spitalin Rajonal Fier.pdf
26. Marreveshje bashkepunimi me Laboratorin Novida.pdf
27. Marreveshje bashkepunimi me Laboratorin Biokimik DIELLI.pdf
28. Marreveshje bashkepunimi me Laboratorin Mjekesor - Magi Balcans.pdf
29. Trajnim profesional per mbrojtjen e jetes dhe te shendetit.pdf
30. Raporti analitik i perfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit Bachelor ne Teknik Laboratori ne Mjekesi.pdf
31. Stafi akademik i Fakultetit te Shkencave Mjekesore 2018 - 2019.pdf
32. Stafi akademik i Fakultetit te Shkencave Mjekesore 2019 - 2020.pdf
33. Stafi akademik i Fakultetit te Shkencave Mjekesore 2020 - 2021.pdf
34. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf
35. Vendim per emerimin e Koordinatorit te Programit - TLM.pdf
36. Ndarja e lendeve ne TLM.pdf
38. Udhezuesi per punimin e temes se diplomes.pdf
39. Orari i mësimor Semestri I - Teknik Laboratori ne Mjekesi.pdf
40. Orari i mësimor Semestri II. - Teknik Laboratori ne Mjekesi.pdf
41. Kalendar i provimeve TLM - Semestri I..pdf
42. Kalendar i provimeve TLM - Semestri II..pdf
43. Suplementi i diplomës Teknik Laboratori ne Mjekesi.pdf
44. Urdher nr. 32 dt. 20.03.2020 per zhvillimin ONLINE te procesit mesimor në IAL..pdf
45. Google Classroom Manuali student.pdf
46. Manual për programin OBS për regjistrim Video dhe audio.pdf
47. Google Classroom Manual pedagogu.pdf
48. Vendim Nr. 2, datë 11.02.2022 i Rektorit - Per miratimin e planit te masave per zhvillimin e provimeve - Semestri I. 2020-2021.doc.pdf
49. Detyrat e koordinatorit të programit.pdf
50. Plan Masash - për zhvillimin e provimeve dhe mbylljen e vitit akademik 2020-2021 - Semestri II. 2021.pdf
51. Rregullore mbi Masat Sanitare ne rastet e gjendjes se Fatkeqesise Natyrore..pdf
52. Rregullore NJSBC.pdf



53. Formular NJSBC - Vleresim i studentit per pedagogun 2019-2020.pdf
54. Formular per Studentet - per vitin akademik 2019-2020.pdf
55. Formular vetevleresimi i pedagogut 2019 - 2020.pdf
56. Formular vleresimi aktiviteti - NJSBC - pyetesor.pdf
57. Vendim nr. 1 dt.18.10.2019 - Miratim strukture NJSBC dhe ZBNJ.pdf
58. Raport vjetor i NJSBC 2019-2020.pdf
59. Raporti Vjetor i IAL - 2019-2020.pdf
60. Plan pune i NJSBC per vitin akademik 2020-2021.pdf
61. Plan pune per kerkimin shkencor 2020-2021.pdf
62. Buletini Shkencor Reald.pdf
63. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve.pdf
64. Vendim i Bordit per miratim fondi per Keshillin Studentor.pdf
65. Model i Diplomës - TLM.pdf
66. Rregullore e Sekretarise Mësimore.pdf
67. Plan Pune i kerkimit shkencor 2019-2020.pdf
68. Formati i Dosjes personale te stafit akademik.pdf
69. Njoftim per aplikim per rekrutim stafi akademik.pdf
70. Procedura per rekrutimin e stafit akademik.pdf
71. Laboratorët në IAL.pdf
72. Planimetria REALD. Godina A..pdf
73. Planimetria REALD. Godina B..pdf
74. Libra te rinj të shtuar në biblioteken e IAL. 2020.pdf
75. Lista e librave në IAL - në gjuhen angleze.pdf
76. Poster per Informimin e Publikut.pdf
77. Pasqyrat Financiare - viti 2020.pdf
78. Vendim i Bordit per miratim fondi per Keshillin Studentor.pdf
79. Kontrate pune e stafit te ri akademik.pdf
80. Rregullore e Kodit të Etikes.pdf
81. Rregullore e diplomimit.pdf
82. Vendim per miratimin e Pasqyrave Financiare - viti 2020.pdf
83. Rregullore e Këshillit të Karrierës.pdf
84. Rregullore e Qendres Kerkimore.pdf
85. Rregullore e zyres se Burimeve Njerezore.pdf
86. Të dhëna mbi regjistrimin e studentëve në programin Bachelor ne TLM.pdf
87. Te dhena mbi punësimin e studentëve të diplomuar 2016-2019.pdf
88. Propozim i Njesise Bazë për hapjen e programit te studimit..pdf
89. Vendim i Dekanatit për hapjen e programit te studimit..pdf
90. Vendim i Senatit Akademik per miratimin e hapjes se programit te studimit..pdf
91. Vendim i Bordit të Administrimit per miratimin e hapjes së programit të studimit..pdf
92. Urdher i Ministrit të Arsimit per hapjen e programit te studimit Bachelor në Teknik Laboratori në Mjekësi.pdf
93. Aktimi i miratimit te Rregulloreve te IAL.pdf
94. Plan Masash per zbatimin e rekomandimeve te BA.pdf
95. Plan Masash nr. 10 dt. 13.01.2020 Per zbatimin kontrollin dhe raportimin e detyrave te planit vjetor të IAL- 2020.pdf
96. Fletë-Palosje - Rald-2020.pdf
97. Relacion - Për analizen e realizimit të detyrave te parashikuara ne planin e masave.pdf
98. Lista e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin Bachelor në Teknik Laboratori në Mjekësi..pdf
100. Vetëdeklarim i Rektorit.pdf
101. RVB - Bachelor ne Teknik Laboratori në Mjekësi..pdf
101. Anatomia dhe Histologji .pdf
102. Anatomia Patologjike viti II.pdf
103. Bioetike viti I.pdf
104. Biokimi Klinike viti II.pdf
105. Drejtim dhe Menaxhim Laboratori viti III.pdf

106. Farmakologji viti II.pdf
 - 107.Fiziopatologjike viti II.pdf
 - 108.Hematologji viti II.pdf
 - 109.Histologji dhe citopatologji viti II.pdf
 - 110.Imunologji viti I.pdf
 - 111.Informatike viti I .pdf
 - 112.Mikrobiologji Klinike viti II.pdf
 - 113.Mikrobiologji viti I.pdf
 - 114.Patologji Klinike viti II.pdf
 - 115.Praktika Profesionale viti II.pdf
 - 116.Praktika Profesionale viti III.pdf
 - 117.Praktike Profesionale viti I.pdf
 - 118.Psikologji viti I.pdf
 - 119.Teknika Laboratike Histo dhe citopatologjike viti II.pdf 12:08
 - 120.Teknika Laboratorike Diagnostifimi Histokimik viti III.pdf
 - 121.Cv e stafit akademik
 123. Shkrese percjellese ne ASCAL- RVB dhe dokumentacioni plotesues
-

